




RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

MERCOM COMPANY SH.P.K.
RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË
MJEDIS.

Objekti Afarist- linjë për prodhimin e
mobiljeve, depo përcjellëse dhe administratë
P+1 Babush i Muhaxherëve, Lipjan

RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS



**IMPIANTI I KOMPANISË MERCOM COMPANY SH.P.K.
PËR OBJEKTIN AFARIST- LINJË PËR PRODHIMIN E MOBILJEVE, DEPO PËRCJELLËSE
DHE ADMINISTRATË P+1
NË LOKACIONIN BABUSH I MUHAXHERËVE TE KOMUNËS SE LIPJANIT**

Vlera investive:	1,957,522.25 € (Një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e shtat mijë e pesëqind e e njezet e dy euro dhe njëzet e pese cent)
------------------	--

Mars 2025

**IMPIANTI I KOMPANISË MERCOM COMPANY SH.P.K.
PËR OBJEKTIN AFARIST- LINJË PËR PRODHIMIN E MOBILJEVE, DEPO
PËRCJELLËSE DHE ADMINISTRATË P+1
NË LOKACIONIN BABUSH I MUHAXHERËVE TE KOMUNËS SE LIPJANIT
ZONA KADASTRALE BABUSH I MUHAXHERËVE; PARCELA NR: P- 71409059 –
00559 – 15.**

Aplikuesi:

MERCOM COMPANY SH.P.K

Fehmi Agani, hyrja 96, kati 1, nr.1

Obiliq

Tel: +383 45 507 600

E-mail:

saranda.elshani@mercomcompany.com

Hartuesit e raportit:

Email: astrit-shala@hotmail.com

Tel: 044800098

Adresa: Prishtinë

Aplikuesi:

Hartuesi i raportit:

MERCOM COMPANY SH.P.K

Dr.sc. Astrit Shala

Mars 2025

PËRMBAJTJA

1	Hyrje	6
2	KUADRI LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT	7
2.1	Metodologjia e punës.....	8
3	PËRSHKRIMI I PËGJITHSHËM I MJEDISIT DHE LOKACIONIT	9
3.1	Pozita gjeografike e projektit.....	10
3.2	Karakteristikat Fiziko-Gjeografike.....	11
3.2.1	Ndërtimi Gjeologjik.....	11
3.2.2	Tektonika	14
3.2.3	Karakteristikat Pedologjike	16
3.2.4	Karakteristikat Hidrografike.....	18
3.3	Karakteristikat Klimatike	19
3.3.1	Temperatura e ajrit	20
3.3.2	Reshjet.....	21
3.3.3	Erërat.....	21
3.4	Flora dhe Fauna.....	22
3.5	Peizazhi.....	25
3.6	Trashëgimisë Natyrore	26
3.7	Trashëgimisë Kulturore	27
3.8	Popullsia dhe shëndeti publik.....	29
4	PROCESIT TEKNOLOGJIK PËR prodhimin e mobiljeve	30
4.1	Përshkrim i projektit dhe Objektit	30
4.1.1	Përshkrimi i projektit (materialet që do të përdoren)	30
4.1.2	Rregullimi i sipërfaqeve të lira dhe atyre gjelbëruese	32
4.2	ARKITEKTURA	32
4.2.1	Punët parapregaditore-Pregatitja e terrenit.....	32
4.2.2	Punët e dheut dhe të zhavorit.....	32
4.2.3	Punët e armaturës.....	33
4.2.4	Punët e konstruksionit metalik.....	33
4.2.5	Punët e betonit.....	33
4.2.6	Punët e Muratimit	33
4.2.7	Pllaka e meskatit.....	34
4.2.8	Streha	34
4.2.9	Punët e Suvatimit	34
4.2.10	Punët e fasadës	34
4.2.11	Estrihu	34
4.2.12	Dyshemeja.....	34

4.2.13	Muret e banjove	35
4.2.14	Lyerja	35
4.2.15	Punët e Kulmit	35
4.2.16	Ulluqet.....	35
4.2.17	Punët e Hidroizolimit.....	35
4.2.18	Dyert dhe Dritaret	35
4.2.19	Ujësjiellësi dhe kanalizimi.....	35
4.2.20	Punët e infrastrukturës së jashtme	36
4.2.21	Punët e rrethojës.....	37
4.2.22	Instalimi i linjës kabllore	38
4.2.23	Rrufepriti.....	38
4.2.24	Ndërtimi i objektit	38
4.2.25	Teknologjia	39
4.2.26	Menaxhimi i kostos dhe Analiza e kthimit nga investimi (ROI)	39
4.3	Përshkrimi i procesit teknologjik	39
4.3.1	Platoja e kompleksit.....	40
4.3.1	Përshkrimi i procesit teknologjik	40
5	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	57
5.1.1	Ndotja e ajrit.....	57
5.1.2	Ndotja e ujit.....	58
5.1.3	Ndotja e tokës	58
5.1.4	Zhurma	58
5.1.5	Ndikimi në florë dhe faunë.....	58
5.1.6	Ndikimet në raste aksidentale	58
6	MASAT PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS	59
6.1.1	Masat për eliminimin e ndikimeve të dëmshme	59
6.1.2	Masat për mbrojtjen e ajrit	59
6.1.3	Masat mbrojtëse të ujërave	60
6.1.4	Masat për mbrojtjen e tokës	61
6.1.5	Masat për mbrojtjen nga zjarri.....	61
6.1.6	Masat për mbrojtjen nga zhurma.....	62
6.1.7	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore – zjarri	62
6.1.8	Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës	62
6.1.9	Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidentale	63
6.2	Menagjimi i mbeturinave	63

6.2.1	PROGRAMI I MONITORIMIT	64
6.2.2	RAPORTIMI	64
6.2.3	MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT	64
6.2.4	KONKLuzion	65
7	REFERENCAT	65

Lista e Figurave:

Figura 1. Harta Pozita gjeografike e Komunës.....	9
Figura 2. Pozita gjeografike e projektit.....	10
Figura 3. Pozita e lokacionit ne hapësirën e komunës se Lipjanit.	11
Figura 4. Harta gjeologjike e Lipjanit.	14
Figura 5. Harta morfostrukturore e Kosovës me tendencë mbizotëruese në ngritje	16
Figura 6.Harta Pedologjike e komunës se Lipjanit.	18
Figura 7. Harta e karakteristikave te ujërave nëntokësore.	19
Figura 8.Rajonet Klimatike në Kosovë.	20
Figura 9. Trëndafili erës në komunën e Ferizajt si komunë fqinje e Lipjanit.	22
Figura 10. Ligatina e Hencit.....	23
Figura 11. Harta e Ligatina e Hencit – Radevës.	24
Figura 12. Forsythia europaea (Boshtra)Vendbanimi i llojit endemik Forsythia europaea.	25
Figura 13. Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.	27
Figura 14. Shpella e Mermertë në Gadime.	28
Figura 15. Foto nga Blinaja.	29
Figura 16. Planimetria e parcelës zhvillimore kadastrale.	30
Figura 17. Pamja e Fabrikës në 3D.....	31
Figura 18.Sharra Format 4 Kappa v60 Tabela 1 Specifikat e sharrës të Format 4 Kappa v60	42
Figura 19. Specifikat teknike te Format 4 Creator 950.....	43
Figura 20. Format 4 Creator 950 Tabela 3 Specifikat teknike Profil 45z.....	44
Figura 21. Format Kappa e-motion 590.....	45
Figura 22. Sharra Vertikale Format 4 Kappa V60 Tabela 5 Specifikat teknike Format Kappa V60.....	46
Figura 23. FORMAT 4 Profit H08	47
Figura 24.Mayer Advanced line 100 Tabela 7 Specifikat teknike të Mayer Advanced Line 100	48
Figura 25.iX interio- skema se si funksionon.....	48
Figura 26.Kompresori i ajrit.....	49
Figura 27.Sistemi i ekstrimit te pluhurit	50
Figura 28.Pamje e sharres me instruzion Tabela 10 PSecifikat teknike te Mayer Kappa Automatic 140	51
Figura 29.Tempora 60.12.....	52
Figura 30.Format4 Creator 950.....	53
Figura 31.Format Profit 45Z.....	54
Figura 32.Kabineti i larjes	55
Figura 33.Tavoline lemimi.....	55
Figura 34.Seti i veglave te lemimit.....	56
Figura 35.Pistoleta për spërkatje	57
Figura 36. Skema e trajtimit te ujerave fekale.....	60
Figura 37. Kantat për klasifikimin e mbeturinave ditore.....	64

1 HYRJE

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis për IMPIANTIN E KOMPANISË MERCOM COMPANY SH.P.K. PËR OBJEKTIN AFARIST- LINJË PËR PRODHIMIN E MOBILJEVE, DEPO PËRCJELLËSE DHE ADMINISTRATË P+1 NË LOKACIONIN BABUSH I MUHAXHERËVE TE KOMUNËS SE LIPJANIT ZONA KADASTRALE BABUSH I MUHAXHERËVE; PARCELA NR: P- 71409059 – 00559 – 15, është përgatitur sipas kërkesave të legjislacionit mjedisor të Kosovës, veçanërisht sipas Ligjit Nr.08/L-181. për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Edhe pse si aktivitet nuk përfshinë djegie të lëndëve fosile, ndërhyrje fizike të theksuara në mjedis apo shfrytëzim të resurseve ujore, megjithatë, si aktivitet, nëse i pakontrolluar, mund të ketë ndikime në mjedis, prandaj edhe është subjekt i procedurave për pëlqim dhe leje mjedisore.

Kompania MERCOM COMPANY SH.P.K ka iniciuar hartimin e raportit të VNM-së për të identifikuar ndikimet e mundshme në mjedis, me qëllim të ndërmarrjes së masave të nevojshme dhe zgjedhjen e alternativave për minimizimin e ndikimeve negative në mjedis.

Raporti përshkruan gjendjen e përgjithshme në dhe rreth lokacionit të projektit, kushtet mjedisore ekzistuese, përshkrimin teknik të projektit që është realizuar, ndikimet e mundshme të projektit në mjedis, si dhe masat për parandalimin apo minimizimin e ndikimeve në mjedis. Identifikimi i ndikimeve potenciale në mjedis, identifikimi i masave për zbutjen e këtyre ndikimeve si dhe ndërmarrja e masave adekuate për të ndikuar në evitimin apo minimizimin e ndikimeve të këtij projekti në mjedis, janë komponentët kryesorë të këtij raporti.

Në terren janë realizuar vizita në lokacionin e projektit, janë bërë matjet e nevojshme të lokacionit me GPS, është incizuar gjendja e terrenit dhe janë bërë fotografi për lehtësimin e përgatitjes së këtij raporti. Raporti është punuar në bashkëpunim të ngushtë me investitorin, prej të cilit janë marrë të dhënat kryesore dhe të nevojshme përmes bisedave

Raporti është hartuar në bazë të informatave të siguruara nga Web faqja e komunës së Lipjanit, nga literatura ekzistuese për zonën,. Për hartimin e këtij raporti janë përdorur të dhëna nga përshkrimi teknik i projektit si dhe të dhëna dhe materiale relevante për projekte të ngjashme.

Veprimtaria e prodhimit të detergjenteve, parimisht vlerësohet se do të ketë vlerësim minimal në mjedis, ndërsa një ndikim me të madhe mund të kenë në ujera.

Ngritja respektivisht zhvillimi i kësaj veprimtarie pa dyshim se do të ndikon pozitivisht në të mirë të krijimit të prodhimeve vendore si dhe në aspektin socio-ekonomik përmes krijimit të vendeve të reja të punës.

2 KUADRI LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT

Për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM-në) është miratuar Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2023 me Nr.08/L-181. Ky ligj përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM-së. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ka për qëllim që të siguroj një vlerësim të qartë të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur. Për përgatitjen e këtij raporti janë shfrytëzuar ligjet dhe rregulloret ekzistuese të Republikës së Kosovës si dhe rregullat relevante dhe praktikrat e mira nga vendet e ndryshme të BE-së, direktivat përkatëse për mjedis siç është Direktiva e VNM-së, dhe Direktiva e Habitave 92/43/EEC, 1992. Ligjet më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e VNM-së për këtë projekt janë si më poshtë:

- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08/L-181
- Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110,
- Ligji nr. 04/L-012 për mbrojtje nga Zjarri,
- Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji Nr. 08/L-112 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tokën Bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Rrugë Nr. 2003/11
- Ligji Nr. 06/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 03/L-120
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060 - shtojca
- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji Nr. 08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedurat të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative

- Udhëzimi Administrativ për vlerat kufizuese të efluentit që shkarkohet në trup ujor dhe në rrjetin e kanalizimit publik.

2.1 Metodologjia e punës

Për të vlerësuar ndikimin në mjedis si dhe për të identifikuar masat para parandalimit dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, për impiantin për përpunimin e plastikes, është ndjekur qasja e vlerësimit të përgjithshëm të projekteve të kësaj natyre, si dhe është bërë analiza dhe identifikimi i ndikimeve sipas fazave.

a) Informatat themelore mbi:

- Burimet themelore të ndikimeve në mjedis
- Popullatën dhe vendbanimet në lokacion
- Topografia dhe peizazhi në lokacionin e projektit
- Klima dhe të dhënat meteorologjike
- Kualiteti i ajrit ujit dhe komponentëve tjerë mjedisor në lokacion
- Bota bimore dhe shtazore në lokacionin e projektit

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas kriterëve në vijim:

- Gjendja e mjedisit në lokacionin e projektit
- Lloji dhe madhësia e pritshme e ndotjes nga projekti
- Karakteristikat dhe përbërja e materialit ndotës
- Vlerësimi i përhapjes së ndotjes

c) Përcaktimi i masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis, duke u bazuar në rezultatet / të gjeturat nga vlerësimi i ndikimeve në mjedis, në lokacionin e projektit.

3 PËRSHKRIMI I PËGJITHSHËM I MJEDISIT DHE LOKACIONIT

Komuna e Lipjanit ndodhet në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës, në jug të kryeqytetit të vendit (Prishtina), ku ndahen rrugët kryesore të rajonit. Ajo kufizohet me komunat: Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë, Prishtinë, Drenas, Suharekë, Malishevë, Shtime, Ferizaj, Gjilan dhe Artanë.




Figura 1. Harta Pozita gjeografike e Komunës.

Komuna e Lipjanit është një pikë strategjike për trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, pasi aeroporti ndërkombëtar ndodhet në territorin e saj dhe është vetëm 15km nga qendra. Në anën perëndimore shtrihet rezervati Blinaja, ku ka potencial për t'u kthyer në një qendër rekreative dhe atraktive për tërë rajonin. Në vendbanimin Gadime gjendet Shpella e mermerit që paraqet një atraksion të rëndësishëm turistik jo vetëm për Komunën e Lipjanit, por për tërë Kosovën. Parku kulturo-historik në Kleçkë dhe Divjakë, si dhe qyteza e vjetër Janjeva, e cila po ashtu konsiderohet si vend atraktiv për vizitorët.

Territori administrativ i komunës është i pozicionuar në jug të Prishtinës, dhe mbulon sipërfaqen prej 338.54 km². Dendësia e popullsisë 170 b/km², e përafërt me mesataren e popullsisë në shkallë vendi 159.31 b/km², 3.2% e territorit të shtetit.

Territori i Komunës së Lipjanit është një urë lidhëse në mes të rajoneve pasi Përmes territorit të komunës së Lipjanit kalon hekurudha, e cila lidh këtë territor në të gjitha drejtimet me rajonin në tërësi, gjithashtu kalon edhe Lumi i Sitnices.




Figura 2. Pozita gjeografike e projektit.

3.1 Pozita gjeografike e projektit

Zona e projektit (shih figurën më lartë e rrethuar me ngjyre të kalter) ndodhet në juglindje të Komunës së Lipjan në Zonën Industriale Babush i Muhaxherëve, Lipjan.

Lokacioni i impianti i kompanisë IMPIANTI I KOMPANISË MERCOM COMPANY SH.P.K. PËR OBJEKTIN AFARIST- LINJË PËR PRODHIMIN E MOBILJEVE, DEPO PËRCJELLËSE DHE ADMINISTRATË P+1 NË LOKACIONIN BABUSH I MUHAXHERËVE TE KOMUNËS SE LIPJANIT ZONA KADASTRALE BABUSH I MUHAXHERËVE; PARCELA NR: P- 71409059 – 00559 – 15.




Figura 3. Pozita e lokacionit në hapësirën e komunës së Lipjanit.

3.2 Karakteristikat Fiziko-Gjeografike

Territori i Komunës së Lipjanit gjendet në lartësinë mbidetare mbi 500m ose 43.0 % të sipërfaqeve (bruto) gjinden në pjesën e rrafshët do të thotë gjer në 600m të lartësisë mbidetare të cilat janë edhe më të përshtatshme për prodhimtarinë bimore.

3.2.1 Ndërtimi Gjeologjik

Stratigrafia e Paleozoikut (fPZ2)- Në pjesën qendrore dhe jugore të njësisë së Drenicës, formacionet paleozoike tregojnë shtrirje lineare veri veriperëndim-jug juglindje. Në Drenicë dhe Jezerc, në perëndim të Kaçanikut janë zhvilluar rreshpe sericite, klorit-sericite, kuarc-sericite, filite etj. me ndërthurje të mermereve dhe epidote aktinolite. Në pjesët e sipërme të seksioneve janë zhvilluar argjilofilitët dhe metaranorët. Por mungojnë të dhëna për faunën. Në hartat gjeologjike në shkallën 1:100.000 të fletëve të Ferizajt dhe Kaçanikut, këto formacione janë të indeksuara të Permo-Triasikut, por ne mendojmë se i përkasin moshës paleozoike.

Stratigrafia e Triasikut (sT1-2)- Në pjesën jugore të Njësisë së Drenicës, në Jezerc, gëlqerorë të dollomitizuar, shtresorë, të laminuar dhe gëlqerorë pllakorë me silicorë përmbajnë bivalvë pelagjikë. Gëlqerorët me silicorë kanë në pjesën e sipërme silicorë radiolaritike të kuqrremtë dhe mbi to shistet me blloqe (melanzhin tektono – olistostromik). Foto 2. Në gëlqerorë janë përcaktuar konodonte të Triasikut të Mesëm – të Sipërm (në veri të ngushticës së Përroit të Dërmanit) Lonchodina sp., Prinaidella cf. pecteniformis. Mendojmë që gëlqerorët pllakorë me silicorë, në nivelet e sipërme, i takojnë Jurasikut, ashtu si dhe silicorët e kuq radiolaritike dhe shistet me blloqe (melanzhi tektono – olistostromik).

Stratigrafia e Jurasikut (J2-3) - Kemi dalje të kufizuar të melanzhit tektono – olistostromik. Në jezerc, stratigrafia e Jurasikut nga posht lartë, paraqitet si në vijim:

- a. Gëlqerotët pllakorë me silicorë të ndërshtresuar tepër hollë. Gëlqerorët janë të laminuar dhe paraqiten të metamorfizuar duke u kthyer në gëlqerorë të mermerizuar. Përmbajnë bivalvorë të shumtë pelagjik. Në nivele të poshtme të gëlqerorëve, me anë të konodonteve argumentohet mosha Triasik e Mesme – e Sipërme e tyre.
- b. Mbi gëlqerorë pllakorë me silicorë, vijnë gëlqerorë mergelore pllakorë me silicorë. Në rajone me prerje të ngjashme, këto nivele litostratigrafike janë argumentuar faunistikisht si të Jurasikut të Poshtëm – të Mesëm (me *Involutina liassica*, *Protopenneroplis striata*, etj.)
- c. Në tavan të gëlqerorëve pllakorë me silicorë, takohen zhveshje me prani të silicorëve radiolaritik të gjelbër e të kuqrrëmte (trashësia deri 10) (Jurasik I Mesëm).
- d. Mbi gëlqerorë pllakorë me silicorë dhe silicorët radiolaritikë, shtrihen me pajtim strukturor shistet me blloqe (melanzhi tektono – olistostromik I Jurasikut të Mesëm – të Sipërm). Në matriksun argjilor të shistëzuar “notojnë” blloqe ranorësh kuarcorë dhe arkozikë, silicorësh radiolaritik, bazaltesh, etj. Melanzhi shoqërohet edhe me fragmente luspore akrecionare serpentinitesh. Për nga pamja, ngjyra, ndërtimi etj., shistet me blloqe të Jezercit, janë identike me ato të Vrellës, Radavcit etj., që gjithashtu shtrihen normalisht mbi gëlqerorët triasiko – liasike dhe radiolaritet e Jurasikut të Mesëm.

Mbi formacionet e përshkruara mësipër, shtrihet me mospajtim strukturor, formacioni fllishor Volljaku I Jurasiko – Kretakut të Poshtëm.

Stratigrafia e Neogjenit Np1 - Përfaqësohet nga sedimente bazale zhavorr - ranore, që kanë përhapje në disa nivele të terrenit të Kosovës, nga kuota 600 deri në 750 m në pellgun e Dukagjinit, Drenicës dhe Fushës së Kosovës. Trashësia e këtyre depozitimeve është rreth 10 m dhe shtrihen mbi sedimentet e Miocenit dhe Pliocenit, rrallë mbi depozitimet e formacionit fllishor të Senonianit.

Në rajonet e Fushës së Kosovës, depozitimet liqenore të vjetra të Pleistocenit shfaqen në Veriperëndim të këtij pellgu, afër Vushtrrisë dhe Mitrovicës, në Veri të pellgut të Gjakovës afër fshatrave Shushicë, Sinejë dhe Veriç. Ato shtrihen mbi depozitimet liqenore të Miocenit e Pliocenit dhe më rrallë të fllshit. Poshtë, përfaqësohen nga suargjiila të kuqërremta, kafe të errëta zhavorrore, surëra me zhavorr, suargjiila në disa vende. Trashësia luhet nga 5 në 20 m dhe vendosen në nivelet +500 deri në 650 m.

Depozitimet liqenore janë të përhapura edhe në pjesën jugore të pellgut të Kosovës, në Ferizaj, Bibaj, Sazli dhe në Moravën e Binçës, afër fshatrave Tankosiq, Terstenik dhe Sllatinë. Vendosen mbi depozitimet e pellgut të Fushës së Kosovës, në kuotën 580-600 m dhe në Moravën e Binçës, në kuotën 540 m. Përfaqësohet nga argjiila, ranorë të kuqërremtë, zhavorre, rëra, argjiila me konkrecione, ose thjerrëza karbonatesh. Trashësia e tyre është rreth 30 m.

Në Jug të pellgut të Fushës së Kosovës, depozitimet liqenore zëvendësohen me depozitime lumoro - akullnajore të dukshme në rrafshnaltën e Lubotenit. Niveli i shtresave liqenore të Pleistocen - Holocenit në pellgun e Kosovës është 600 m (ky është edhe niveli që ndan depozitimet liqenore me ato akullnajore).

Tarracat e vjetra - takohen në luginën e Ibrit dhe Sitnicës. Veçohen dy nivele: njëri i vjetri, në nivelin 580 - 620 m dhe tjetri, i riu, në nivelet e sotme të luginës, përbëhen nga sedimente copëzore, me përbërje të ndryshme.

Depozitimet tarracore në rajonin e Fushës së Kosovës dhe Besianës, formojnë 5 nivele t1-530 m., t2-539 m, t3 në 545 m, t4-580-600 m dhe t5 në 630-650 m. Ato fillojnë që nga qyteti i Prishtinës e deri në përroin e Llapit në lumin Sitnicë. Përbëhen nga zhavorre, rëra dhe suargjila. Zajet e zhavorreve përbëhen nga kuarci dhe më rrallë nga shkëmbinjë metamorfikë. Madhësia e zajeve luhetet nga 1 cm deri në 10 cm. Në tarracën e katërt zhavorrore, materiali paraqitet si brekçe shpati.

Proluvione të vjetra – në fushëgrykën e rrafshit të Kosovës dhe të Moravës së Binqës, janë takuar tarraca me grumbullime kaotike të zhavorreve dhe rërave. Proluvionet përbëhen nga konglomerate zhavorrore, me zaje kuarci stralle, diabaze, gëlqerore, serpentinite etj. Trashëisia e këtyre shtresave kaotike të proluvioneve të vjetra arrin deri në 10 -15 m.

Stratigrafia e Kuaternarit pQh, aQh- Në depozitimet kontinentale të Holocenit janë përfshirë: aluvionet, proluvionet, deluvionet, rrëzimet, morenat, gurët akullnajorë.

1. Aluvionet - Depozitime të zhavorreve dhe rërave janë takuar në luginat e lumenjve Erenik, Lumëbardhi i Pejës, Deçanit dhe i Lloçanit, si dhe në lumenjtë Ibër, Sitnicë, Drenicë, Nerodime, Drini i Bardhë, Kujavç etj. Përbëhen nga zhavorre e rëra dhe rrallë nga ndërshtresa suargjilore.

2. Proluvionet - janë konstatuar në rrafshnajën e Moknës, afër Sinejës dhe Mojstirit, në afërsi të fshatit Raushiq, në përrenjtë Sushicë, Lubeniq, Strellc etj. Përbëhen nga copa gëlqerorësh me madhësi 5-20 cm, me forma të çrregullta dhe gjithkund përfaqësojnë konuse të derdhjeve ujore, që mbushen vazhdimisht me material që vjen nga këto rrjedhje, për shkak të pjerrësive të mëdha të tyre. Depozitimet janë gjithkund heterogjene. Proluvionet kanë përhapje të madhe, po ashtu në pjesën juglindore të Prizrenit, midis Prizrenit dhe Mushtishtit. Më të kufizuara janë vërejtur dhe në pjesën jugperëndimore, në anën e majtë të luginës së Lumëbardhit të Prizrenit. Po ashtu, në luginën Toplugë, Mamushë, Plavskë midis Brodosanës dhe Zapluxhës, në krahun tjetër në Gjonaj e Lubizhdë, në Pashtrik.

Deluvionet ose materialet e shpateve - Përbëhen nga përzierje copash të shkëmbinjve të dryshëm e material suargjilor, suranor dhe janë takuar në shumë rajone, përmendim ato të Kodrës së Pashës në Prizren, Junik, në Mushtisht etj. Trashësia e deluvioneve, në disa vende arrin deri në 50 m.

5. Rrëzimet - Materiale të rrëzimeve të shpateve (pa material argjilor) janë në malet e Gjeravicës, Ropsit, Rrasës së Zogut, Koprivnikut dhe në shpate të tjera malore. Copat janë të madhësive të ndryshme, me forma të çrregullta të parrumbullakosura, me forma qoshelie, me përbërje si të shkëmbinjve rrënjësorë, nga janë shkëputur.

6. Tokat e kuqe (Terra rossa) - Mbi gëlqerorët e Triasikut dhe të Kretakut të Sipërm, në Koritnik dhe Pashtrik vërehen sedimente të kuqërremta suargjilore, trashësia e të cilave në Kurilo, arrin deri në 10 m.




Figura 4. Harta gjeologjike e Lipjanit.

3.2.2 Tektonika

Tiparet themelore të tektonikës së zonës me interes - ona me interes I përket zonës së njësisë tektono – stratigrafike të Drenicës, njësi e cila është ndarë për herë të parë në librin Gjeologjia e Kosovës (Elezaj, 2008). Njësia e Drenicës përhapet në trajtë të një brezi 15 -25 km të gjerë, përgjatë buzës perëndimore të njësisë së Jashtme të Vardarit. Kufiri tektonik mes tyre kalon afërsisht sipas drejtimit Mitrovicë – në Perëndim të Qiqavicës, Shtimes, Ferizajit e Kaqanikut. Në perëndim, Njësia e Drenicës, në pjesën veriore kufizohet me njësinë e Pejës, në pjesën qendrore me Njësinë e Malishevës, ndërsa në vazhdim jugor, me njësinë e Radushës.


Në aspektin e neotektonikës, zona ku është për interes, bënë pjesë në blloqet e trevave me tendencë në ngritje. Këto treva ndahen në blloqe me ngritje të shpejtë (blloku 4) dhe blloqe me ngritje të ngadaltë (blloku 8), në fakt zona në fjalë ndodhet në kufirin e këtyre dy trevave. Fig. 5.

Bloku 4. - Ky bllok emërohet si blloku I Mushtishtit. Është I ndërtuar nga formacione të paleozoikut dhe I vendosur në mes të bllokut të Bjeshkëve të Sharrit, në Jug, Ultësirës së Dukagjinit në Veriperëndim dhe njësisë së Përbërë të Vardarit në Lindje. Bloku I Mushtishtit është I ngritur në mënyrë asimetrike: në pjesën jugore deri në 1500 m dhe në Veri, në drejtimin e Budakovës ulët shkallë – shkallë, prej 1200 – 1300 m, duke kaluar në bllokun tjetër, I njohur si blloku I Carralevës.

Në brendi të bllokut nr. 4, përveq shkëputjeve anësore, nuk ekzistojnë shkëputje të tjera, të vequara. Vlen për tu përmendur se në të njëjtën pjesë veqohet shkëputja (7), përgjatë së cilës në mënyrë diapirike kanë depërtuar trupat e serpentiniteve. Edhe pse në ditët e sotme kjo shkëputje e vjetër nuk ka elemente për ndonjë aktivitet sizmik, përgjatë saj mund të ndoshin tërmete me intensitet të ulët.

Përgatë luginës së lumit Lepenc, manifestohet shkëputja (8), si shkëputja e Lepencit, e cila siq kallëzojnë pamjet nga sateliti, ndiqet edhe jashtë këtij territori.

Bloku 8 - Këtij blloku I takojnë terrenet në pjesën qendrore të Kosovës (Drenicë – Qiqavicë). Pjesa jugore e kësaj njësie neotektonike, në Veriperëndim të Shtimes, është e ngritur në një lartësi deri në 800 m, përderisa në drejtimin verior është e ngritur edhe deri në 900 m e më tepër. Sipas morfologjisë së këtij terreni mund të konkludohet se ky terren, gjatë Neogjenit ka qenë I mbizotëruar nga tendenca në ngritje, që ka kushtëzuar peneplenizimin e tij dhe herë pas here ka qenë I përfshirë nga sedimentet pliocenike. Shkëputjet që u takojnë pjesëve të jashtme të këtij blloku përfaqësojnë pjesë të shkëputjeve të Njesisë së Përbërë të Vardarit (7) dhe shkëputjet e pjesës së skajshme perëndimore të Ultësirës dhe në pozicion tërthor, të cilat janë me karakter lokal e aktiviteti I të cilave nuk është I përcaktuar. Megjithatë, formimi I Basenit të Kosovës në Lindje dhe të Drenicës në Perëndim, tregojnë se edhe ky bllok mund të jetë bartës I sizmicitetit lokal.



- Smonicat e eroduara dhe smonicat e kafenizuara me pseudoglej, të cilat gjenden në territore më të larta malore, prandaj erozioni i eroduar ka çuar pjesërisht një pjesë të horizontit humusor, duke i bërë këto toka gjysmë të thella deri të cekëta.
- Tokat aluviale përfaqësojnë rreth 22.87% të sipërfaqes, dhe kryesisht këto toka gjenden rreth degëve të lumit “Sitnica”. Këto janë toka me veti të përshtatshme fiziko-ujore dhe me vlerë të lartë bujqësore. Në këto toka organizohet prodhimtari intensive bujqësore.
- Tokat e kafenizuara të cekëta në rrasat shkëmbore-ranore janë të përfshira me rreth 5.67% dhe tokat e kafenizuara të mesme të thella në rrasat shkëmbore-ranore përfshinë 8.54% dhe’. Këto toka dhe tokat e tjera të kafenizuara gjenden në terrenet e larta dhe kryesisht janë toka pyjore nën pyje.
- Tokat livadhore – teltnore dhe tokat livadhore-argjillore janë të përfaqësuara me rreth 3% dhe gjenden kryesisht përreth lumit “Sitnica”.
- Tokat podzole-pseudoglej janë toka, të cilat e kanë vlerën e kufizuar bujqësore për shkak të cilësive (vetive) të këqija ujoro-fizike dhe shtresën punuese e cila nuk e lëshon ujin, dhe ka përmbajtje të madhe argjillore. Në mënyrë që këto toka të shfrytëzohen intensivisht në bujqësi është e nevojshme që të bëhen masat agromelioruese.
- Tokat deluviale përfshinë 5.36% nga territori i përgjithshëm i komunës.




Figura 6.Harta Pedologjike e komunës se Lipjanit.

3.2.4 Karakteristikat Hidrografike

Në aspektin hidrografik ujrat në komunën e Lipjanit i takojnë pellgut të Detit të Zi, ndërsa lumenjtë më të mëdhenjë janë lumi Sitnica dhe Drenica të cilët janë edhe nën degë të lumit Ibër. Në përgjithësi rrjeti hidrografik është i pasur dhe me potencial ujorë të varfër, i kushtëzuar nga sasia e vogël e reshjeve mesatare shumëvjeqare (600mm). Lumi Sitnica është lumi më i madhë në komunë e Lipjanit i cili degët më të zhvilluara i ka në anën lindore, ndërsa degët kryesore hidrografike të anës lindore janë: Lumi Janjevka, Lumi i Zhegovcit, Lumi i Gadimës dhe Lumi Sazlisë ndërsa, në anën perendimore lumi më i zhvilluar është Lumi i Vërshevcit.

Sasitë më të mëdha të reshurave janë gjatë muajit prill dhe maj, prandaj periudha pranverore është ajo kur paraqiten vërshimet dhe kur kemi edhe paraqitjen e kënetave, posaçërisht në tokat të cilat nuk e lëshojnë ujin.”.




Figura 7. Harta e karakteristikave të ujërave nëntokësore.

3.3 Karakteristikat Klimatike

Kosova karakterizohet nga një klimë kontinentale dhe është nën një ndikim të nivelit të ulët të klimës mesdhetare dhe regjimit alpin në malet e larta.





Figura 8. Rajonet Klimatike në Kosovë.

3.3.1 Temperatura e ajrit

Temperatura e Ajrit është një nga elementët klimatikë që karakterizon klimën e një rajoni. Temperatura e ajrit është një parametër i rëndësishëm që përcakton gjendjen e klimës dhe mjedisit atmosferik. Me regjimin mesatar, trendin ditor dhe vjetror, dhe vlerat ekstreme, temperatura e ajrit ka një ndikim potencial në strukturat si dhe vetë panelet diellore. Një nga parametrat kryesorë të temperaturës së ajrit janë vlerat mesatare. Shpërndarja brenda vjetore e temperaturave të ajrit për stacionet e Prishtinës, Lipjan tregohet në tabelën dhe figurën më poshtë.

Table 1. Temperaturat mesatare mujore e ajrit në stacionin e Prishtinës, 2020 ndaj periudhës 2010-2019




Bazuar në të dhënat statistikore mund të konkludohet se temperaturat mesatare mujore variojnë nga -5.0 °C në Janar në 24.0 °C në Korrik.

3.3.2 Reshjet

Reshjet janë një nga elementët klimatikë të cilët përcaktojnë karakteristikat klimatike të një zone. Faktorët që ndikojnë në karakteristikat e reshjeve janë, vendndodhja, distance nga deti dhe orografia. Në tabelën me poshtë jepen reshjet për disa stacione meteorologjike.

Table 2. Sasia totale mujore e reshjeve (mm) në stacionin e Prishtinës, 2020 ndaj periudhës 2010–2019



Në Kosovë vërehen disa lloje reshjesh si shiu, bora dhe shiu i imët. Sasia e reshjeve rritet me rritjen e lartësisë nga niveli I detit si dhe në drejtimin Lindja-Perëndim. Sasia më e madhe e reshjeve bie gjatë muajve Janar, Shkurt, Mars dhe Tetor, ndërsa sasia më e vogël në muajt Qershor, Korrik dhe Gusht. Sasia më e lartë e reshjeve vjetore është regjistruar në muaj Prill.

Në bazë vjetore në Lipjan bien afërsisht 822 mm shi, pak më shumë bie në Pejë (907mm) dhe sasia më e ulët e reshjeve vërohet në Istog, 659 mm. Bora vërohet rregullisht në dimër, ndërsa kohëzgjatja e mbulesës me borë është relativisht e vetëm 16.4 ditë në Istog dhe rreth 22.5 ditë në Klinë. Fusha e Lipjan përjeton një numër të madh të ditëve me mjegull (48.4 ditë) veçanërisht gjatë vjeshtës.

3.3.3 Erërat

Frekuncën më të madhe vjetore në rajonin e Ferizajt dhe Shtimes e kanë era verilindore (NE) me 226 0/00 ndërsa më të voglën ato lindore (E) me gjithsej 36 0/00. Shpejtësia mesatare është më e madhja të era jug perëndimorë (SW) 4,0m/sec, sipas të dhënave të IHMK.




Figura 9. Trëndafili erës në komunën e Ferizajt si komunë fqinje e Lipjanit.

3.4 Flora dhe Fauna

Trashëgimia natyrore i referohet biodiversitetit duke përfshirë florën dhe faunën, ekosistemet dhe strukturat gjeologjike. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i natyrës është i rregulluar sipas ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës. Sipas këtij ligji, inventarizimin e të gjithë përbërësve të larmisë biologjike, gjeologjike e peizazheve - llojet, tipit të vendbanimeve, gjeolokaliteteve dhe të peizazheve paraqitjen hartografike të llojeve të kërcënuara, gjeolokaliteteve dhe tipat e vendbanimeve etj. bëhet nga ana e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Që nga themelimi i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) janë marrë nën mbrojtje ligjore shumë zona, monumente dhe vlera tjera të natyrës në mesin e të cilave janë edhe asetet e Trashëgimisë Natyrore të komunës së Lipjanit.

Ligatina e Hencit - Radevës - Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve

Ligatina e Hencit - Radeves shtrihet në pjesën qendrore të fushës së Kosovës, në afërsi të Aeroportit Ndërkombëtar "Adem Jashari" në mes të fshatrave, Henc - komuna e Fushë Kosovës, Vrellë – komuna e

Lipjanit dhe Radevë - Komuna e Graçanicës në lartësi mbidetare rreth 545m dhe sipërfaqe të përgjithshme prej 109 ha 52 ari 35 m².



Figura 10. Ligatina e Hencit.

Kjo zonë është krijuar nga bashkimi i rrjedhave ujore të Magurës dhe Vrellës, të cilat janë degë e majtë e lumit Sitnica. Ligatina është krijuar në vitet e '60-ta, me qëllim të kultivimit të llojit të peshkut Krap (*Cyprinus carpio*). Ligatina e Hencit - Radevës duke pasqyruar se është i vetmi ekosistem i llojit të tillë në Kosovë edhe pse i formuar në mënyrë artificiale, karakterizohet me vlera të veçanta natyrore si: ornitologjike, ihtiologjike, hidrogeologjike, botanike, peizazhore etj. Në vitin 2013 është përgatitur arsyeshmërinë profesionale për shpalljen e Ligatinës së Hencit - Radevës zone e mbrojtur. Ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2014 ka nxjerr Vendim (Nr. 08/178, datë 18.03.2014) për shpalljen e Ligatinës së Hencit - Radevës Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve.




Figura 11. Harta e Ligatina e Hancit – Radevës.

Blinaja - Shtrihet në tri Komuna, atë të Lipjanit, Drenasit dhe Shtimës dhe ka një sipërfaqe prej 2795 ha. Llojet kryesore që kultivohen të faunës së egër në Blinajë janë: Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Dreri i kuq (*Cervus elaphus*), Dreri i murrm (*Dama dama*), Derri i egër (*Sus scrofa*), Përveç këtyre llojeve në Blinajë janë prezentë edhe Vjedulla (*Meles meles*), Shqarthe i ahut (*Martes sp.*), Shqarthe i pishës evropiane (*Martes sp.*), Lepuri (*Lepus europeus*), Korbi (*Corvus corax*), Laraska (*Pica pica*), Shqiponja minj ngrënëse (*Buteo buteo*), Rosa e egër (*Anas querquedula*), Macja e egër (*Felis sylvestris*), Ketri (*Sciurus vulgaris*), etj.

Lokaliteti i boshtres- Habitati i llojit endemik Boshtra, një vlerë e shtuar e regjistrit të zonave të mbrojtura. **Ne vitin 2020 është be propozimi nga komuna e Lipjanit për shpallje si zone e mbrojtur. Me pas ne vitin (2021)** - Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka bërë evidentimin e vlerës së natyrës - vendbanimin e llojit endemik Forsythia europaea (Boshtra) që gjendet në kodrën e Goleshit, zonë kjo që përfshinë territorin e Komunës së Fushë Kosovës, Drenasit dhe Lipjanit.

Gjatë periudhës 2018 - 2021 numrit të përgjithshëm të zonave të mbrojtura u janë shtuar gjithsejtë 64 zona të reja (Gjakovë 10, Mitrovicë 12, Obiliq 4, Viti 7, Gjilan 13, Deçan 17 dhe **Lokaliteti i Boshtres në zonën e Goleshit i cili shtrihet ne territorin e komunave: Drenas, Fushë Kosovë dhe Lipjan**).

Grupi punues i përbërë nga përfaqësues të MMPHI-së, Universitetit të Prishtinës dhe nga komunat përkatëse ka hartuar arsyeshmërinë profesionale si dokument bazë për vënien në mbrojtje të kësaj vlere natyrore. Kuvendet e këtyre komunave kanë nxjerrë vendimet mbi shpalljen e territoreve të tyre veç e

veç si zonë e mbrojtur Boshtra (*Forsythia europaea*). Sipërfaqja e tërësishme e kësaj zone është 123.54 ha (51.92 ha Fushë Kosovë, 38.42 ha, në Drenas dhe 33.2 ha në Lipjan). Të dhënat e prezantuara në arsyeshmërinë profesionale janë mbledhur nga arkiva e Institutit i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës por edhe gjatë ekspeditave hulumtuese në terren të realizuara nga ana e grupit punues dhe ekspertë e fushave përkatëse. *Forsythia europaea* (Boshtra) është bimë drurore - shkurre, endemike dhe relikte terciere e Kosovës dhe Shqipërisë. Ky lloj në Kosovë rritet në zona shkëmbore– serpentinore duke krijuar pyje të rralla ose shkurre. Ky lloj është vlerësuar në Librin e Kuq të florës vaskulare të Kosovës në kategorinë LC (më pak i rrezikuar) pasi që lloji për momentin nuk është i kërcënuar në atë masë sa që të futet në ndonjë kategori më të lartë. Habitatet ku rritet ky lloj janë të pasura edhe me lloje tjera endemike dhe relikte që kanë rëndësi shkencore.



Figura 12. *Forsythia europaea* (Boshtra) Vendbanimi i llojit endemik *Forsythia europaea*.

Lokacioni i zonës industriale ku do të ndërtohet ky impiant ne fjalë, ka një distance ne vije ajrore prej zonës se mbrojtur te Lokaliteti Shpelles se Gadimes mbi 2 km dhe rrjedhimisht nuk paraqet ndonjë problem ne kuptimin mjedisor.

3.5 Peizazhi

Peizazhi - paraqet një nga veçoritë e rëndësishme të cilat duhet trajtuar në kuadër të vlerësimit të ndikimeve në mjedis. Edhe pse si definicion, paraqet një tërësi të elementeve natyrore, me vlerë vizuale dhe relaksuese, që d.m.th. në kuptimin e ndotjes dhe emisioneve nuk paraqet efekte direkt në shëndet, megjithatë kjo duhet trajtuar dhe vlerësuar me kujdes.

Zona malore e komunës së Lipjan është e pasur me resurse pyjore, dhe e rrethon pothuajse gjithë komunën duke i shtuar pamjen piktoreskë dhe i jep mushkëri këtij qyteti. Zona malore është shpallur zonë me prioritet për mbrojtjen e natyrës, ri-pyllëzim, rekreacion dhe turizëm. Komuna është e kufizuar me dhënien e lejeve për ndërtim në këto zona. Një pjesë e madhe e zonës malore është e mbuluar me pyje. Malet luajnë një rol të rëndësishëm për florën dhe faunën në komunë, si dhe për klimën globale dhe ekonominë lokale. Druri këtu përdoret për ndërtim, artizanate tradicionale, përpunime industriale dhe ngrohje. Konsiderohet se pjesët e prera të maleve në vitet e fundit duhet ri-pyllëzuar. Për ti riparuar dëmet e shkaktuara, duhet të planifikohet pyllëzim i ri në zonën malore. Për ta siguruar një zhvillim të

qëndrueshëm të pyjeve, prerjet që do të bëhen në të ardhmen duhet të ripyllëzohen me fidanë përkatëse për zonën.

Siç është përshkruar më lartë, lokacioni ku është planifikohet të ndërtohet impianti është një lokacion në perëndim të qytetit të Lipjanit, dhe nuk parashihet që do të sjellte ndonjë problem të madhe në kuptimin e peizazhit, pasi që është shpallur zone industriale e komunës së Lipjanit.

Si përfundim e këtyre argumenteve që u prezantuar, mund të themi që ky projekt nuk paraqet ndonjë kundërshtim, konflikt apo pa pranushmëri në kuptimin peizazhi.

3.6 Trashëgimisë Natyrore

Trashëgimisë Natyrore - Trashëgimia natyrore në këtë zonë janë të pranishme lokacionet e mbuluara me pyje dhe kullosa, të cilat japin një pamje shumë tërheqëse dhe shërbejnë si vende për strehimin e faunës. Te pjesa e gjendjes ekzistuese të komunës janë paraqitur mjaft të dhëna për veçorit natyrore dhe karakteristikat tjera natyrore. Me zgjerimin e disa vendbanimeve janë të njohura edhe disa përzierje veprimtarish komerciale, të industrisë së lehtë e rezidenciale. Zhvillime dhe ndërtimet edhe në disa zona sensitivitet mjedisor, gjeomorfologjik dhe gjeologjik. Zhvillimet dhe ndërtimet në këto zona janë potencialisht të kërcënuara. Një pjesë e mirë e habitateve janë po ashtu të kërcënuara për pasojë të ndryshimit të sipërfaqeve të gjelbërta. Ky ndryshim në përdorimin e tokës ilustron në disa nga shifrat që mundë të jenë në dispozicion edhe se të pakta, ku tregohet shfrytëzimi i tokës në vitet e më hershme dhe tani. Shumëfishimi i disa zonave ndërtimi ka ndodhur në kurriz të tokës bujqësore, të zhdukjes disa pyjeve me pemë me gjethe, dhe ka shkaktuar zvogëlimin e një terisi pasazhesh e gjelbërimi.




Figura 13. Mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

3.7 Trashëgimisë Kulturore

Trashëgimisë Kulturore – Monumentet më i rëndësishëm natyror në komunën e Lipjanit janë është shpella e Gadimes dhe Parku i Blinajës te cilat tashmë janë pikë joshëse e turizmit. Ajo që e bën shpellë më unike është mermeri i paraqitur natyror dhe pjesët horizontale të kristalit në tavanin e shpellës. Prej trashëgimis natyrore është uji termal në fshatin baincë, rezervati blinaja, bukurit e bukura të pasazheve shalë-kleqkë dhe vargmalet e zhegovcit. Në komunën e Lipjanit ekzistojnë vetëm disa monumente historike apo gërmadha historike. Pjesët më të vjetra historike datojnë që nga koha e Ilirëve shekulli 5 dhe 3 para erës sonë, duke pasuar më pastaj gërmadhat e romakëve nga shekulli 3 dhe 4. Monumentet më të vonshme datojnë nga koha e mesjetës. Ndërsa vetëm disa monumente historike datojnë nga koha otomane. Objektet historike me rëndësi të veçantë kulturore janë: Qytetza në fshatin Gadime e Epërme, Bicë, Kleqkë, Kisha e Noter Damit Lipjan Rrënojat e Manastirit Sllavi, Xhami e vjetër në Shalë dhe Shtëpia Muze e At Shtjefën Gjeçovit në Jnajejë.

Shpella e Mermertë në Gadime: Shpella para-historike e mermert në Gadimes u formua 80 milion vite më parë dhe paraqet fenomen karstik unik jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Është e zhvilluar në një thjerrëz të gëlqerorëve me moshë paleozoike të mermerizuar me dimensione të vogla hapësinore e ndërfutur në rreshtet permo-triasike. Fakti se kanalet, galeritë dhe boshllëqet e kësaj shpelle janë krijuar në mermer paleozoiku e bënë këtë shpellë unike dhe te rrallë në botë. Pasuria e shpellës, e cila e bën atë unike, është prania e aragonitëve, të cilat, si zbukurime shpellash, janë ngjarje të rralla. Kristalët e këtyre zbukurimeve në shpellë shfaqen në galerinë e Aragonitit e cila karakterizohet nga forma dhe drejtime të ndryshme të shpellës që e bëjnë shpellën veçanërisht interesante dhe tërheqëse.



Figura 14. Shpella e Mermertë në Gadime.

Blinaja, Territori i Blinajës shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, 15 km në perëndim të qytetit të Lipjanit. Sipërfaqja e Blinajës është 5500 ha dhe shtrihet në territorin e tri komunave: Lipjan, Shtime dhe Drenas. Lartësia mbidetare është prej 670 – 860 m. Prania e 33 liqeneve dhe 60 livadheve krijon peizazhe të bukura dhe të ndryshme të cilat e bëjnë Blinajën shumë atraktive dhe tërheqëse për studiues dhe vizitorë dhe njëherit ofron kushte të volitshme për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore.



Figura 15. Foto nga Blinaja.

3.8 Popullsia dhe shëndeti publik

Në raport me qendrat tjera komunale, Lipjani gjendet në vendin e shtatë sipas numrit të banorëve, në bazë të shënimeve nga viti 1981. Në raport me vendbanimet në kuadër të territorit të saj, Lipjani është qendër e komunës me karakter të qytetit. Sipas numrit të banorëve, Lipjani është vendbanimi më i madh, mandej radhiten Janjeva, Gadimja e Poshtme, Sllovia dhe Magura, kurse sipas sipërfaqes, radhitja është kështu: Sllovia, Gadimja e Epërme, Blinaja, Suhadolli, Zllakuqani, Banulla, Akllapi, Smallusha, Shala e kështu me radhë. Në komunën e Lipjanit jetojnë rreth 57,605 banorë. Në qytetin e Lipjanit jetojnë rreth 10,000 banorë, ndërsa pjesa tjetër jetojnë në zonat rurale (fshatra). Territori administrativ i komunës është i pozicionuar në jug të Prishtinës dhe mbulon sipërfaqen prej 338.47 km², ndërsa dendësia e popullsisë është 169.59 ban/km².

Ndërsa, distanca ne mese te shtëpive dhe lokacionit është mbi 400m (sipas google maps) dhe ne afërsi te lokacionit ku do te ndërtohet ky impiant nuk kemi ndonjë shtëpi.

Shëndeti - Ndikimet në shëndetin e publik për VNM, janë ato te cilat lindin si pasoje e bashkëveprimit me receptorët mjedisore (komponentë mjedisore te tilla si ajërti, uji apo toke nëpërmjet te cilëve ndotësit behën potencial nëpërmjet transportit në ujë dhe kontaktit me njerëzit). Kapaciteti mjedisor i komunës do të thotë, para se gjithash, ruajtja ne nivele të pranueshme e parametrave kryesore mjedisore. Dendësia e popullsisë në disa vendbanime, zhvillimi pa plan i tyre, ulja e hapësirave publike rekreative dhe sidomos te gjelbëria sjell pa dyshim uljen e cilësisë se jetës, përkeqësimin e parametrave mjedisore te pranuar si standarde, shpenzime te larta te shoqërisë për rregullimet e mëtejshme për njësi sipërfaqeje dhe shpenzime me te larta për mbrojtjen e shëndetit. Nga aktiviteti ky aktivitet ekonomik qe pritet te veproje ne ketë zone nuk pritet te ketë efekte ne shëndetin e njeriut. Organizimi i Kujdesit Parësor Shëndetësor në Lipjan bëhet në përputhshmëri të plotë me rregullativën ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë sipas Konceptit të Mjekësie Familjare. Bartës kryesor i këtij koncepti është Mjeku Familjar dhe Institucionet e Kujdesit parësor Shëndetësor siç janë Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendrat e Mjekësisë Familjarë (QMF) dhe Ambulanta e Mjekësisë Familjare (AMF).

[Mercom Company Sh.p.k.](#)

4 PROCESIT TEKNOLOGJIK PËR PRODHIMIN E MOBILJEVE

4.1 Përshkrim i projektit dhe Objektit

Duke u bazuar në raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), projekti për ndërtimin e objektit afarist – linjë për prodhimin e mobiljeve, me depo përcjellëse dhe administratë P+1, do të zhvillohet në zonën industriale të Babushit të Muhaxherëve, Komuna e Lipjanit. Ky lokacion ndodhet brenda kufirit ndërtimor të komunës dhe është i përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve industriale.

Raporti vlerëson se ndikimi i këtij aktiviteti në mjedis është minimal, pasi projekti nuk përfshin ndërhyrje të konsiderueshme në tokën bujqësore, pyjore apo zonat e mbrojtura. Gjithashtu, distanca e objektit nga zonat e banimit redukton ndikimin e mundshëm në komunitetin lokal. Për më tepër, masat e planifikuara për menaxhimin e mbetjeve dhe uljen e ndikimeve në ajër, tokë dhe ujë sigurojnë që projekti të jetë i pranueshëm nga aspekti mjedisor.



Figura 16. Planimetria e parcelës zhvillimore kadastrale.

4.1.1 Përshkrimi i projektit (materialet që do të përdoren)

Projekti në fjalë përfshin projektimin dhe ndërtimin e objektit afarist – linjë për prodhimin e mobiljeve, me depo përcjellëse dhe administratë P+1. Sipërfaqja e objektit është e ndarë në nivele vertikale dhe horizontale, sipas shfrytëzimeve të përcaktuara në projektin kryesor arkitektonik.

Objekti ka destinim industrial dhe afarist, në përputhje të plotë me aktivitetet në atë zonë. Gjithashtu, vlen të theksohet se objekti i projektuar është në harmoni me objektet përreth, me etazhitet të njëjtë, madhësi dhe destinim të përafërt, duke mos cenuar karakterin urban dhe kontinuitetin e zonës industriale të Babushit të Muhaxherëve.

Konstruksioni i objektit është sistem montues, i ndërtuar nga elemente betoni të parafabrikuara. Mbajtësit kryesorë janë shtyllat, ndërsa muret e jashtme janë 20 cm, dhe muret ndarëse sipas nevojës kanë dimensione 12 cm. Shtyllat dhe elementet strukturore janë të dimensionuara sipas llogaritjeve statike për të siguruar qëndrueshmërinë e objektit.

Objekti që do të ndërtohet do të ketë një sipërfaqe totale prej 3,520.72 m² dhe është i ndarë sipas tabelës më poshtë.

Perdhesa-Depo materiali	699.49 m ²
Perdhesa-Show room	642.76 m ²
Perdhesa-Halla prodhuese	1,837.47 m ²
Kati 1- Administrata	340.99m ²
Komplet	3,520.72 m ²



Figura 17. Pamja e Fabrikës në 3D

4.1.2 Rregullimi i sipërfaqeve të lira dhe atyre gjelbëruese

Lokacioni: Objekti është paraparë të ndërtohet në parcelën kadastrale P- 71409059 – 00559 – 115 e cila evidentohet në Z.K.Babush i Muhaxherëve, Komuna e Lipjanit. Qasja në parcelë bëhet përmes rugës lokale publike.

Shfrytëzimi i parcelës kadastrale do të bëhet sipas Kushteve Zhvillimore:

Treguesit bazë:

☐ Madhësia e parcelës: 11 172m²

☐ Balli i parcelës: 00m

☐ Elazhitet: P+0 dhe P+1(Pjesa e show roomit dhe administrates)

☐ Sipërfaqe gjelbëruese e parcelës (SGJP): 4972.00m².

☐ Infrastrukturë me sipërfaqe prej: 2650.00m²

Rrjetet e vijave:

☐ Vija ndërtimore (VN): Sipas planit rregullativ urban

☐ Distanca anësore nga parcela (me hapje primare): 24.00m

☐ Distanca anësore nga parcela (me hapje sekondare): 30.00m

Ndarja e sipërfaqës është bërë si më poshtë:

☐ Ndërtimi i objektit: [32%]

a) Showroom dhe zyre P+1 me sipërfaqe 3209.80m² në përdhesë dhe zyre me sipërfaqe: 340.99m² në kat të parë

b) Hallat e prodhimit, me sipërfaqe: 3209.80m²

☐ Infrastruktura: (23%)

d) infrastruktura (parikingje, rugë brenda parcele, drenazhime, kanalizime, instalime elektrike ndriçim i jashtëm, rrethime të parcelës, etj) me sipërfaqe: 2650.00m².

☐ Sipërfaqja gjelbëruese: [44%]

Gjelbërimi si pjesë përbërëse e objektit, me sipërfaqe prej 4972.00m².

Në total objekti ka këtë sipërfaqe:

Përdhesë dhe Kat prej 3550.80 m²

☐ Përdhesë: 3209.81m²

☐ Kat: 340.99m²

4.2 ARKITEKTURA

4.2.1 Punët parapregaditore-Pregatitja e terrenit

Duhet të pastrohet terreni nga mbeturinat dhe të bëhet rrethimi me një rrethojë të perkohshme e cila do të shërbejë edhe për realizimin e punimeve dhe të bëjë ndarjen fizike nga banorët lokal. Pastaj punëkryesi është i obliguar të sjellë një kontenier në punishte dhe të krijojë kushte për punë për stafin teknik dhe organin mbikqyrës. Do të sigurohet uji i nevojshëm për realizimin e punimeve dhe po ashtu edhe energjia elektrike do të sigurohet nga punëkryesi. Punëkryesi do të ndërtojë edhe një toalet lë perkohshëm derisa të zgjatin punimet e pastaj në mënyrë higjienike t'a tërheqë dhe ta largojë nga punishtja.

4.2.2 Punët e dheut dhe të zhavorit

Së pari duhet të largohet humusi në një trashësi prej 30 cm, kjo pjesë e dheut duhet të dërgohet në deponi apo në ndonjë vend të autorizuar nga personat përgjegjës të komunës. Shtresimi i dheut brenda objektit

do të bëhet sipas normave teknike në ndërtimtari dhe do të ngjeshet çdo 20 cm derisa të arrijë ngjeshmërinë $M_v=10$ Mpa.

Duhet të bëhet hapja e themeleve shiritore dhe të veçanta sipas dimensioneve në projektin kryesor. Pasi të bëhet largimi i dheut të themeleve do të bëhet ngjeshja e themelit dhe të amhet një ngjeshje me mjete adekuate deri në $M_v=40$ Mpa, njëherit duhet të bëhet largimi i dheut të tepërt të gërmuar.

Do të bëhet furnizimi me zhavor 10-32 mm për vendosjen e shtresës së zhavorit nën themele dhe shtresës së zhavorit nën tërë sipërfaqen e dyshemesë së objektit duke e ngjeshur me ngjeshës cilindrikë apo me pasje të tjera adekuate për ngjeshje. Nivelizimi i zhavorit do të bëhet në një precizitet të lartë plus minus 2 cm. Kontrollën e saktësisë do t'a bëjë organi mbikqyrës me anë të instrumenteve matëse, kurse para betonimit do të kryhet edhe matja e ngjeshmënsë $M_v=40$ Mpa me pllakë rrethore.

4.2.3 Punët e armaturës

Pregatitja dhe montimi i armaturës sipas pozicioneve dhe detajeve të paraqitura në projekt për të gjitha pozicionet, trajet shiritore të themeleve, shif statikë sipas logarisë statike të paraparë në projekt, estrihu me rrjetë Q 131. Para se të vazhdohet me punët e betonimit duhet të informohet organi mbikqyrës dhe të vijë në vend punishte e të bëjë verifikimin e pozicioneve të armaturës dhe kontrollën e dimensioneve të saj. Pas aprovimit të organit mbikqyrës do të fitohet me fazat e tjera të punës. Armatura duhet të jetë 5400/500 dhe nuk duhet të përmbajë rrezatim radioaktiv.

4.2.4 Punët e konstruksionit metalik

Konstruksioni metalik i njerës pjesë të objektit është mbulesa që është kapriate lineare-vijore e mbështetur në traje të betonit. Llogaritja statike do të përcillet në detaje si dhe do të bëhen të gjitha testet e saldimit para se konstruksioni të montohet dhe gjithashtu saldimi do të bëhet salduesit e kualifikuar dhe profesional.

4.2.5 Punët e betonit

Betonimi do të bëhet me beton të pregatitur nga betonjerka sipas projektit, duke u bazuar në specifikimin e markës së paraparë të betonit nga llogaria statike për të gjitha pozicionet 25-30 MB. Para vendosjes së betonit në vepër do të kontrollohet ulja e e tij me konus të Abramsit. Së pari do të punohen themelet e pastaj do të vazhdohet me fazat e tjera.

Dimensionet e elementeve konstruktive të objektit janë sipas statikes me pllaka masive $d=18$ cm, trajet, streha e të tjera poashtu sipas detajeve në arkitekturë dhe llogarisë statike.

Për çdo pozicion do të pregatiten mostrat për shqyrtim të markës së betonit nën mbikëqyerjen e organit mbikqyrës dhe të dërgohen në vend me lagështi të lartë 90% ku i plotëson kushtet e kërkuara me rregulloret në fuqi. Pas 28 ditësh, mostrat duhet të thyhen në prani të organit mbikqyrës dhe të vërtetohet marka e kërkuar e betonit. Në rast se nuk plotësohet marka e kërkuar atëherë duhet të shqyrtohet stabiliteti i objektit dhe i pjesëve konstruktive të tij. Trotuari duhet të bëhet nga betoni i armuar në trashësi 10 cm dhe duhet të jetë ndarë në fuga çdo 2m.

4.2.6 Punët e Muratimit

Muratimi do të bëhet me Blloqe të argjilës "giter" me vrima të cilat i plotësojnë kushtet teknike të ndërtimit dhe duhet të jenë blloqe mbushëse e jo mure mbajtëse për shkak se kemi objekt skeletor e jo mure mbajtëse me dim prej 25 x 20 x 20 cm sipas projektit ku muret e jashtme janë me trashësi prej

25 cm kune ato të brendëshmet janë me trashësi prej 20 cm dhe me liaq vazhdues 1:3 (çimento, gëlqere rërë) ose me aditivë të parapregatitura për krijim të llogit për muratim.

Në brendi të hapësirës së brendshme është paraprë një ndarje me mure të blloqeve të argjilës me dim. 12cm. Në këtë pozicion hyn edhe skleria dhe materialet përcjellëse për muralim. Kune gabimi në gabarit të mureve nuk guxon të jetë më i madh se 1 cm e cila verifikohet nga organi mbikqyrës.

4.2.7 Pllaka e meskatit

Pllaka e meskatit do të punohet nga sitemet e pllakes masive me $d=18\text{cm}$. Armimi kryhet sipas llogarisë statike.

4.2.8 Streha

Eshtë pjesë e kapriates lineare dhe mbeshjtjellës me material të njëjtë të fasadës. Pjesa grafike e përcakton daljen në pjesë të caktuara të projektit,

4.2.9 Punët e Suvatimit

Suvatimi i brendshëm do të bëhet me tri shtresa + pregatitja finale për ngjyrë. Ngjyrosja e mureve të brendshme me ngjyrë sipas projektit.

Për suvalim do të përdoren materialet e parapregatitura të llojit "Renofiks" me patinim.

4.2.10 Punët e fasadës

Fasada do të punohet nga materialet e termoizolimit stiropor $d=10\text{cm}$ N4 e cila do të vendoset me anë të tiplave pesë copëshe në një metër katror dhe pastaj të vendoset ngjitësi adekuat që i qëndron lageshtisë, e para se të vendoset të prezantohet atesti tek organi mbikqyrës dhe pas aprovimit të fillohet me punë. Pastaj pas ngjitësit duhet të vendoset rrjeta rabiç e mbi të përseri ngjitës adekuat i cili duhet të jetë absolutisht i rrafshët dhe mbi të të shkohet me anë të Abribit 2mm nga prodhimet europiane. Pastaj duhet të kemi parasysh që realizimi i fasadës do të bëhet në formën e tillë që ngjyra duhet të jetë mbi abrib pasi të teret dhe të arrijë një fortësi të nevojshme (me të gjitha elementet siç janë jetet këndoret, etj).

Ngjyra do të përcaktohet nga organi mbikqyrës.

4.2.11 Estrihu

Estrihu do të jetë me një trashësi prej 5 cm dhe do të jetë i përpunuar mirë pasi mbi të do të punohet finalizimi i dyshemesë. Estrihu do të realizohet nga betoni i markës MB-15.

4.2.12 Dyshemeja

Dyshemeja do të punohet nga materialet e parapara në projekt. Për dyshemet e koridoreve do të përdoret pllaka të granitit artificial 8 mm mbi shtresën e estrihut prej 5cm. Ngjyrën e pllakave e përcakton organi mbikqyrës.

Dyshemeja e banjove do të punohet nga pllakat e qeramikës 8mm me dimensione 33x33 cm kurse ngjyra përcaktohet nga organi mbikqyrës. Pas përfundimit të vendosjes së pllakave do të bëhet plotësimi i fugave dhe ngjyrën e përcakton organi mbikqyrës.

Dyshemeja e ambienteve të zyrave do të punohet nga parketi 22mm bung i klasës së parë. Ngjyra përcaktohet nga organi mbikqyrës. Pasi të përfundohet vendosja e parketit, do të vendosien llajsnet në skaje.

4.2.13 Muret e banjove

Përpunimi i mureve të banjove do të jetë nga qeramikat e klasit të parë dhe do të jenë me trashësinë e kërkuar dmin 7mm me dimensione të paracaktuar ndërsa ngjyrën do e përcaktojë organi mbikqyrës. Fugat do të mbushen nga materiall adekuatë i kërkuar.

4.2.14 Lyerja

Ngjyra e brendshme do të jetë e butë nga polikolori difuzv kurse nuancën e ngjyrave e përcakton organi mbikqyrës. Fasada e jashtme do të jetë Fasadë Ventiluese.

4.2.15 Punët e Kulmit

Ekzekutohet nga materiali llamarinë sandwich me 1=12cm me TR 5cm. Paneli do të jetë sandwich llamarinë nga të dy anët llamarinë, si dhe do të jetë i mbushur me lesh guri të presuar në mes.

Pjesa e kulmit të rrafshët do të punohet me hidroizolim te kualitetit të lartë sipas detajeve të dhëna në projekt si dhe duhet që shtresa perfundimtare të perpunohet me qeramikë të durueshme ndaj lagështive dhe ngricave. Në pjesën e sipërme do të vendosen panelet solare që do të sigurojnë afër 75% të furnizimit me rrymë elektrike të nevoja të fabrikës.

4.2.16 Ulluqet

Ulluqet horizontale dhe vertikale do të vendosen sipas projektit nga llamarina e zinkuar dhe plastifikuar sipas projektit. Ulluqet horizontale do të jenë sipas detajit me gjerësi të zhvilluar afërsisht një meter, kurse shkarkuesit vertikal 12x10 cm. Janë disa dalje të ulluqeve ku do të bëhet shkarkimi i ujit në kanalizim.

4.2.17 Punët e Hidroizolimit

Hidroizolimi do të behet mbi pllakën e dyshemesë së bodrumit me një lyerje nga Bituliti i ftohtë dhe vendosja e shtreses hidroizoluese "kondor 4 mm" ngjitje me temperaturë.

Hidroizolimi do të vendoset në tërë sipërfaqen e dyshemesë.

Mbrojtja e Hidroizolimit do të bëhet me shtresën mbrojtëse -estrih nga ana e brendshme dhe stirodur dhe folje mbrojtëse nga ana e jashtme.

4.2.18 Dyert dhe Dritaret

Dyert dhe dritaret do te vendosen sipas projektit. Lloji dhe kualiteti i tyre janë të parapara në projekt. Dyert do te jenë me hapje palosje lartë me mekanizma automatik.

Dritaret do të punohen nga materialet Alumin me urë termike 80mm nga prodhuesit Alumila, Elvial ose Schuko, kursa dyert e kthinave do të jenë nga druri. Të gjitha detajet dhe hapjet në konsultim me organin mbikqyrës, paraprakisht për materialet do të konsultohet organi mbikqyrës dhe të prezentohen tri mostrat e parapara nga punëkryesi.

Dera e kaldatorës do të jetë nga metali dhe do të ketë një hapje për ajrosje.

4.2.19 Ujësjiellësi dhe kanalizimi

Projekti kryesor për furnizim me ujë të pijës dhe largimin e ujërave të zeza dhe atyre të bardha, parasheh që të kryhet sipas zgjidhjes arkitektonike të dhënë dhe sipas normave në fuqi për projektim, për fazën e ujësjiellësit dhe kanalizimit.

1. Rrjeta e ujit është projektuar sipas llogaritjeve hidraulike për nyje sanitare me ujë të bollshëm dhe presion të mjaftueshëm për objektin. Projekti do të përmban rrjetin e jashtëm që është prej kycjes në rrjetin publik poashtu edhe në bunar e deri tek' ormani shpërndarës, rrjetin e brendshëm që përfshinë komplet rrjetën e brendshme nga ormani shpërndarës deri te pikat e shfrytëzimit.

- Furnizimi i objektit me ujë është paraparë të bëhet nga rrjeti i ujësjellësit dhe nga bunari, për ujë të pijes dhe nevojave sanitare. Rrjeti i brendshëm është nga sistemi italian GIACOMINI por mund të vendosen edhe sisteme të tjera pasi që nuk kemi të bëjmë me pajisje të shumta sanitare dhe kërkesa të mëdha për ujë.
- Gypat në tokë të vendosen mbi shtresë të rërës në trashësi prej 7-12cm dhe mbështjellën me "Plamaflex".
- Gypat e ujit të ftohtë në mur mbështjellën me shirita izolues.
- Ventilet me kapak të ponikluar ose me rotë vendosen në gypat e ujit të ftohtë sipas skemës së ujësjellësit.

2. Rrjeti i Kanalizimit është projektuar në bazë të llogaritjeve hidraulike për largimin e ujërave të zeza, projekti do të përmbajë jetën e jashtme të kanalizimit që përbëhet nga kyaja në kanalizimin publik e deri tek gropa septike kryesore. Rrjell i brendshëm i ujërave të zeza përbëhet nga jeti i brendshëm dhe nga gropa septike kryesore e deri tek pikat shfrytëzuese dhe ujërat e ndotura (nëse për çfarëdo arsye nuk ka qasje në kanalizimin e qytetit, atëherë duhet të parashihet gropa septike sipas normave.

3. Rrjeti i brendshëm: Do të punohet nga gypat e PP POLUPROPILENIT dhe ramja do të jetë 2% në drejtim të derdhjes në pusetën kontrolluse. Materiali për shfrytëzim do të jetë 125 mm, 100mm.75mm dhe 50 mm.

4. Rrjeti i kanalizimit të ujrave të bardha: Eshtë projektuar si kombinim i drenazhimit dhe largimit të ujërave atmosferike sipas llogaritjeve hidraulike. Ky rrjet do të absorbojë edhe mjedhjet nga pullazi ku në fund do të shkarkohen në pusetat kryesore. Rrjeta do të jetë nga materialet speciale për arenazha, tubat do të jenë të brinjëzuar me diametër od-125 HDPE me rame>1%.

5. Rrjeti i Kanalizimit të jashtëm: Tubacionet nga materiall HDPE me diametër d-125mm për shkarkimet e banjove dhe tuba 00-125 për largimin e ujrave të ndotura nga pjesa e sipërme e lavamanave ku do të bashkohen në pusetën kontrolluese.

4.2.20 Punët e infrastrukturës së jashtme

Në këtë pozicion hyjnë të gjitha punët e jashtme të ndërtesës duke kalkuluar parkingjet, rrugët deri të depo e materialeve, asfalti, kubëzat, skajoret, etj, Gjithashtu, të gjitha furnizimet dhe shpërndarjet e instalimeve: ujësjellës, kanalizim dhe elektrikë. Të gjitha këto janë të trajtuara edhe në pjesën grafike të projektit.

4.2.21 Punët e rrethojës

Parcela parashihet të rrethohet me garah të përhershëm mbrojtës në të gjitha anët e parcelës, ndërsa tek hyrja duhet të jetë porta hyrëse me kontroll të hyrjes dhe një portë tjetër kontrolluese për hyrje/dalje të automjeteve transportuese.

Pas përfundimit të punimeve në objekt, do të demolohet rrethoja e përkoshme, të bëhet pastrimi i terrenit dhe pastaj të punohet rrethoja e re e cila do të punohet sipas projektit.

Vërejtje :

Para fillimit të ekzekutimit të punimeve, punëkryesi do të njoftohet me terenin (shikim terreni), për zbatimin e projektit bashkë me zyrtarët komunal.

Projekti i elektrikës është i bërë në bazë të projektit të ndërtimit dhe arkitekturës për këtë llojë objekti. Shpërndarja e kuadrove shpërndarës nëpër pozicionet adekuate në objekt:

- Shpërndarjen e ngarkesave nëpër objekt
- Instalimet e lidhjeve telefonike dhe televizive
- Instalimi i rufepritësit
- Instalimi i sistemit të alarmit

Nga kuadri kryesor hyrës furnizohet omani shpërndarës kryesor OSH-K me kabël të tipit NYMJ5x26mm² i vendosur në gypin e brinëzuar "Fi" 23 të shtrirë nën llaq. Ormani shpërndarës kryesor OSH-K është prej llamarinës e dekapiruar me trashësi 2mm dhe i mbrojtur nga korozioni me ngjyrë antikoroduese dhe mbrojtje mekanike IP 54. Ormani duhet të jetë i gatshëm për vendosje në murë dhe do të ketë dimensione të tilla që të përfshijë të gjitha elementet nga skema njëpolare. Dyert e ormanit do të kenë bravën dhe çelsin, kurse në anën e brendshme të derës do të vendoset skema njëpolare e instalimit elektrik. Lidhjet brenda në orman ndërmjet elementeve të ndryshme elektrike do të realizohen me përçues fleksibil P/F me seksion adekuat

- OSHS realizohet me mbrojtje diferenciale mymore FID -0.03A dhe siguresave njëpolare automatike.
- Shpërndarja e ngarkesave elektrike të objektit realizohet me kablllo të tipit NYM-J me seksione përkatëse konform ngarkesës. Çdo kabëll furnizues sigurohet në fillim me siguresa përkatëse konform seksionit dhe gjatësisë së kabllit.
- Prizat monofaze furnizohen me kabel NYM-J 3x2.5mm² Prizat trefazore furnizohen me kablllo NYM-J5x2.5mm².
- Ndriqimi realizohet me kabell NYM-J3x1.5mm² dhe përfundon në llampat fluroshente 4x18W.

Kuadri kryesor nyrës KKH, shpërndarsi kryesor SHIK dhe shpërndarësi sekondar do të realizohen në bazë të skemave, njëpolare të dhëna për secilin shpërndarës.

Mbrojtja nga tensioni i rrezikshëm i prekjes është zgjedhë me sistemin e tokzimit mbrojtës prandaj duhet të realizohet përmes mbrojtjes diferenciale rrymore FID-45A dhe FID 25A të tipit ETI, me rymë të gabimit 3mA. Mbrojtja e qarqeve elektrike bëhet përmes siguresave automatike të prodhimit SIloven "ETI" në bazë të skemës njëpolare të cilat vendosen në ormanin kryesor shpërndarës OSH-K të cilat janë të tipit "L" me mbrojtje elektromagnetike dhe termike, dhe çkyçjen e qarkut elektrik e bëjnë

në momentin kur myma e çkyçjes është 3.5-5 herë më e madhe se rryma nominale e siguresës (Ino), pra $i_{\text{çk}} = (3.5-5) I_{\text{no}}$.

Tokëzimi do të bëhet përmes gypave të zinguar "fi" 50mm me gjatësi 1-3m, kurse lidhja ndërmjet veti do të kryhet me anë të shiritit të zinguar FeZn 25x4mm dhe do të vazhdohet deri te kaseta e nyjes matëse të tokëzimit, kurse prej kasetës së nyjes matëse, deri te kuadri kryesor hyrës KKH me përçues fleksibil HO7 1X10mm². Sondat do të vendosen në tokë në formë të trekëndëshit me gjatësinë e krahëve 1=6m.

4.2.22 Instalimi i linjës kablllore

Në objekt parashihet që të instalohet priza e internetit dhe televizionit. Instalimi i internetit do të realizohet përmes përçuesit të tipit Ti 20- 2X0.8 me gypa të PVC nën llaq dhe priza RJ45.

- Instalimi i TV do të realizohet përmes kabllit koaksial KEL 75/4/068 të vendosur në gypa të PVC nën llaq.
- Instalimi do të ekzekutohet sipas dokumentacionit të prezentuar dhe dispozitave ligjore për instalime elektrike.

Materiali i përmendur në përgjithësi do të jetë kualitativ dhe do t'i përgjigjet normave ligjore.

Të gjitha përkuesit janë prej bakrit sipas projektit. Përçuesat vendosen horizontalisht dhe vertikalisht e kursesi pjerrtë. Ndarja e përçuesve dhe vazhdimi mund të bëhen vetëm në kutija shpërndarëse të dimensioneve përkatëse.

Të gjithë ndërprerësat duhet të vendosen në lartësi 1.20m prej dyshemesë. Prizat "shuko" do të vendosen në lartësi 0.4m prej dyshemesë.

Për çdo çark të mymës në ormanin shpërndarës kryesor OSH-K do të vendoset mbishkrimi adekuat.

Nga ana e brendshme e kapakut të ormanit OSH-K do të vendoset skema njëpolare.

Ekzekutuesi i instalimeve elektrike do të sigurojë garancionin me shkrim për instalim që do të kryhet dhe materialin e përdorur, për afatet e parapara sipas kontratës prej ditës së pranimit teknik

4.2.23 Rrufepritësi

Rrufepritësi realizohet duke filluar nga themelet, ku në mes të armaturave të themeleve në zonën e poshtme vendoset shiriti i zinguar FeIn 25X4mm dhe saldichet në çdo 0.40m nëpër U zingia. Përmes lidhjeve kryq, në katër shtyllat e skajshme të objektit vazhdohet me shirit të zinguar FeZn 25X4mm deri te kutitë për matje (lidhjet matëse të cilat vendosen në të katër shtyllat e skajshme të objektit dhe nëpër armaturën e shtyllave vazhdimisht vendoset në mes të armaturave të shtyllave) bartet deri te pllaka përfundimtare nga e cila nxjerret shiriti i zinguar dhe bartet nëpër pikat e skajshme dhe pikat më të larta të kulmit me shirit të zinguar FeZn 20X3mm ku në çdo 1m vendosen mbajtësit e shiritit.

4.2.24 Ndërtimi i objektit

Projektimi dhe zhvillimi i një objekti modern dhe efikas është kyç për krijimin e një mjedisi të favorshëm për aktivitetet tona të prodhimit. Masat dhe veprimet kryesore në këtë fazë përfshijnë:

- **Përsosmëri arkitekturore:** Projektimi është bërë në atë formë që të bëhet optimizimi i hapësirës duke pas në konsideratë efikasitetin e energjisë dhe funksionalitetin.
- **Materiale cilësore:** Përdorimi i materialeve me cilësi të lartë dhe të qëndrueshme për ndërtim për të siguruar jetëgjatësinë e ambienteve tona.

- **Siguria:** Sigurimi që ndërtimi do të bëhet sipas standardeve të ndërtimit, standardeve të sigurisë dhe respektimit të rregulloreve mjedisore.

4.2.25 Teknologjia

Integrimi i teknologjisë së fundit në proceset tona të prodhimit është një shtytës kryesor i Inovacionit dhe produktivitetit.

Masat në këtë fushë përfshijnë:

- **Automatizimin:** Zbatimi i automatizimit aty ku është e mundur për të mitur efikasitetin e prodhimit, për të zvogëluar kostot dhe për të minimizuar gabimet.
- **Integrimin Dixhital:** Përdorimi i mjeteve dixhitale për monitorimin e procesit, analizën e të dhënave dhe menaxhimin e slokut për të thjeshtuar operacionet.

4.2.26 Menaxhimi i kostos dhe Analiza e kthimit nga investimi (ROI)

Gjatë gjithë procesit të investimit, menaxhimi rigoroz i kostos dhe analiza e Kthimit nga Investimi (ROI) janë masa integrale për të siguruar kujdes financiar dhe qëndrueshmëri afatgjatë, duke pasqyruar parasysh Mbikëqyrjen e buxhetit dhe Modelimin financiar.

4.3 Përshkrimi i procesit teknologjik

Procesi teknologjik i prodhimit të mobiljeve përfshin disa faza kyçe, duke filluar nga përzgjedhja e materialeve të përshtatshme, prerja dhe përpunimi i drurit, montimi dhe përfundimi i produkteve të gatshme. Përdorimi i makinerive moderne të përpunimit siguron një efikasitet të lartë dhe një cilësi të qëndrueshme të produkteve finale.

Në këtë proces, materialet bazë si druri, MDF, kompensata dhe materialet tjera ndihmëse i nënshtrohen operacioneve të ndryshme si:

- **Prerja dhe formatizimi,** ku materialet përpunohen sipas dimensioneve të kërkuara.
- **Frezuar dhe gdhendur,** për të krijuar detaje dhe dizajne specifike.
- **Montimi dhe lidhja e komponentëve,** duke përdorur metoda të avancuara të lidhjes si vida, ngjitës industrial ose sistemet me kapje.
- **Lyerja dhe përfundimi,** që përfshin aplikimin e mbrojtjes nga lagështia, ngjyrosjen dhe lustrimin për një pamje estetike të lartë.

Kjo metodë e prodhimit është e përshtatshme për një gamë të gjerë produktesh mobilieri, duke përfshirë pajisje për hapësira banimi, zyra dhe ambiente afariste. Përmes përdorimit të teknologjisë bashkëkohore, synohet rritja e efikasitetit, minimizimi i mbetjeve dhe sigurimi i një standardi të lartë cilësie në produktet e përfunduara.

Kompleksi i Objekti Afarist- linjë për prodhimin e mobiljeve, depo përcjellëse dhe administratë P+1, do të përbëhet prej pajisjeve dhe objekteve të cilat si tërësi nevojiten për realizimin e

veprimtarive të fabrikës si dhe mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet e mundshme negative që shkaktohen nga fabrika. Në vijim po i shënojmë pajisjet dhe objektet që do e përbëjnë kompleksin e Fabrikës:

Objekti i administratës

Halla e prodhimit

Makinat për prerje të lëndës drusore

Ventilatori për tërheqjen e pluhurit

Filtri me thasë për pastrimin e ajrit nga makinat prerëse, përpunuese, gdhendëse

Pajisjet për polerim

Kompresori për furnizim me ajër

Trafo elektrike

Ormanët elektrik

Tabelat komanduese

Pompa me sistemin e furnizimit me ujë

Gjeneratori për furnizim me energji elektrike

Depoja e materialeve të gatshme

Depoja e lëndëve të para

Rrugët dhe hapësirat për parkim,

Oazat gjelbëruese,

Rrethoja e lokacionit.

4.3.1 Platoja e kompleksit

Platoja e kompleksit të Fabrikës për punimin, montimin dhe ekspozimin e objekteve nga druri i parafabrikuar do të rregullohet ashtu që pjerrtësia të është e përshtatshme për përcjelljen ujërave sipërfaqësore, të tërë pjesës për rreth objektit administrativë dhe për rreth kompleksit do të jetë e betonuar.

Organizimi për funksionimin e fabrikës do të jetë i destinuar për funksionimin e qarkullimit në rrugën, hyrja dhe dalja automjeteve transportuese të lendeve të para dhe prodhimeve të gatshme në kompleksin e fabrikës do të bëhet pa pengesë sepse hapësira për hyrje dhe dalje të fabrikës do të jetë e mjaftueshme e përshtatshme dhe dukshmëria është e mirë.


4.3.1 Përshkrimi i procesit teknologjik

Lënda e parë, drusore si dhe lëndët tjera ndihmëse të përmendura më sipër, do të sjellën gati se të gjitha nga importi me ndihmën e kamionëve deri në depon e Fabrikës për prodhimin e shtëpive të parafabikuara në Fabrikë në Babush i Muhaxherëve, Komuna e Lipjans. Pasi që rruga magjistrale Prishtinë Lipjan është rreth 1.5 km metra larg fabrikës (nga rruga lokale e shtruar me asfalt), importi i lëndës së parë është i lehtë dhe pa probleme. Lënda e parë pastaj nga depoja

dimensionohet sipas kërkesave dhe planit të përgatitjes së shtëpive të parafabrikuara dhe përpunohet në makineritë tjera ashtu që sipas kërkesave bëhet prerja, gdhendja, polerimi, montimi i pjesëve ndihmëse të mureve të shtëpive të parafabrikuara dhe në fund paketimi dhe përgatitja për eksport. Pasi të përfundohet me përpunimin e shtëpive të parafabrikuara, të njëjtat dërgohen në depon e produkteve të gatshme dhe pastaj pas paketimit sipas kërkesave të secilit produkt, transportohen te klientët.

Përshkrimin e këtij procesi teknologjik e kemi paraqit në mënyrë skematike.

SKEMA TEKNOLOGJIKE E PRODHIMIT TE SHTËPIVE TË PARAFABRIKUARA



Gjatë fazës së parë, kompania planifikon të bëjë investimet fillimisht përfshijnë:

- ❖ Linja e Përpunimit të HPL 1 - shërbime b2b - Industrisë së Mobiljeve
- ❖ Linja e Përpunimit të HPL 2 - përpunimi i bazuar në projekte - Industrisë Ndërtimore
- ❖ Mjetet Digjitale
- ❖ Infrastruktura e Përgjithshme e Përdorshme

Lista e pajisjeve për Përpunimin e HPL - shërbime b2b - industrisë së mobiljeve:

4.3.1.1 Sharra Vertikale 4 Kappa V60

Makineria e parë në këtë linjë do të jetë Sharra Vertikale dhe do të përdoret për prerjen e paneleve HPL me precizion të lartë dhe për shkak të orientimit të saj vertikal, zë vetëm 5 metra katrorë.



Thellësia e prerjes	60 mm
Gjatësia e prerjes lartësia e prerjes	3,300 mm / 4,300 mm 1,900 mm
	4,300 mm / 5,300 mm 2,200 mm
Lartësia e prerjes se pjesshme	1,810 mm / 2,110 mm
Diametri i sharrës (mm)	250 mm
Kërkesa për ajër	1400 m³/h
Norma e rrjedhës se ajrit	≥ 20 m/sec
Diametri i lidhjes së bashkëngjitjes	120 mm
pesha	900 kg - 1,200 kg
Fuqia e sharrës ne kw	4kw




Figura 18.Sharra Format 4 Kappa v60 Tabela 1 Specifikat e sharrës të Format 4 Kappa v60

4.3.1.2 Qendra e Përpunimit CNC Format 4 Creator 950

Proceset më kohe mbajtëse gjatë përpunimit CNC të HPL janë kohëzgjatja e përgatitjes së paneleve në makinë. Për të zvogëluar kohën e përpunimit për përpunimin e HPL, kompania ka vendosur të përdorë avancimet në teknologji për të zgjidhur këtë problem dhe makina që do të përdoret në fabrikën e re është Format 4 Creator 950. Kjo makinë nuk përdor "pods" por ka algoritme inteligjente që menaxhojnë manipulimin e materialit përmes mbajtjes së materialeve nëpërmjet klembeve, të cilat bazohen gjithmonë në llojin e proceseve që janë në përdorim.



Specifikat teknike te Format 4 Creator 950

Lloji i Makinës	CNC Machining Center
Konsumi Elektrik	14 kw/h
Lidhja Elektrike	5x4 mm ²
Konsumi i Ekstraksionit të Ajrit	3000m ³ /h
Lidhja e Ekstraksionit të Pluhurit	200mm
Konsumi i Ajrit të Kompresuar në nl/min	600nl/min
Norma e Rrjedhjes së Ajrit	≥ 28 m/sec
Okupimi i Hapësirës në mm	2400x2100
Pesha në kg	1950kg

Figura 19. Specifikat teknike te Format 4 Creator 950

4.3.1.3 Formuesi Format 4 Profil 45Z

Elegant, perfektë i projektuar dhe i mençur – Formati 4 i profilit 45Z ofron perfeksion në një shtypje të butonit, pavarësisht nga operacioni. Pika kulmore për përdoruesin profesionist: lartësia dhe këndi i rregullimit të spindle-si, si dhe pozicionimi i hekurit të spindle-si mund të rregullohen shpejt dhe lehtë nga paneli i kontrollit. Sistemi i shpejtë i ndërrimit të spindle-s siguron kohë shumë të shpejtë të ndërrimit dhe efikasitet maksimal në procesim. Gjatë vëllimeve të larta të procesimit, veçanërisht gjatë pikut të sezonit, Formuesi do të përdoret për të zvogëluar kohën e përpunimit të makinës CNC duke përfunduar kanat në makinë.



Format 4 Creator 950 Tabela 3 Specifikat teknike Profil 45z

Lloji i Makinës	Shaper
Konsumi Elektrik	8kw/h
Lidhja Elektrike	5x2.5 mm ²
Konsumi i Ekstraksionit të Ajrit	1110m ³ /h
Lidhja e Ekstraksionit të Pluhurit	140mm ,80mm
Konsumi i Ajrit të Kompresuar në nl/min	n/a
Norma e Rrjedhjes së Ajrit	≥ 20 m/sec
Okupimi i Hapësirës në mm	2870x1294
Pesha në kg	650kg

Figura 20. Format 4 Creator 950 Tabela 3 Specifikat teknike Profil 45z

4.3.1.4 Sharra Horizontale

Të gjitha hapat e prerjes mund të kryhen shpejt, me efikasitet dhe qender për shkak të integritetit të sistemit të optimizimit të prerjes në makinë dhe konceptit të veprimit. Trajnim nuk është i nevojshëm pasi ndërfaqja e përdoruesit është intuitive, e qartë dhe e lehtë për përdorim. Stampuesi i etiketave mundëson që punëtorët të etiketohen në mënyrë të saktë, dhe gjithashtu mundëson një pas-përpunim logjik. Kjo bën të mundur ngarkimin e programeve për proceset e mëvonshme në makinat CNC dhe makinat për prerje të kanateve thjesht duke përdorur skanerin e bar kodeve. Ruan kohën e çmuar procesimi me stampuesin e etiketave dhe rrit produktivitetin, cilësinë dhe si rezultat, fitimin tuaj.



Format Kappa e-motion 590

Specifikat teknike Format Kappa e-motion 590

Lloji i Makinës	Horizontal Saw
Konsumi Elektrik	10 Kw
Lidhja Elektrike	5x6mm ²
Konsumi i Ekstraksionit të Ajrit	600m ³ /h
Lidhja e Ekstraksionit të Pluhurit	100mm
Konsumi i Ajrit të Kompresuar në nl/min	
Norma e Rrjedhjes së Ajrit	≥ 20 m/sec
Okupimi i Hapësirës në mm	8300x3400
Pesha në kg	1300kg

Figura 21. Format Kappa e-motion 590

4.3.1.5 Përpunimi i HPL - përpunim i bazuar në projekte - industrisë ndërtimore

Ky është një lloj i përpunimit të sipërfaqeve të pllakave të lëmuara me presion të lartë (HPL), i cili përdoret në industrinë ndërtimore dhe ka të bëjë me punimin e projekteve të veçanta. Këto projekte përfshijnë zakonisht instalime të pllakave në ndërtesa, objekte publike, dhe konstruktive të tjera. Përdorimi i pllakave HPL në industrinë ndërtimore është i zakonshëm për shkak të përparësive të tyre të qëndrueshmërisë, rezistencës ndaj vrimave, dhe pamjes estetike tërheqëse.

Për shembull, pllakat HPL janë shpesh përdorur për përpunimin e fasadave të ndërtesave, banjove publike, dhe ambienteve të tjera të qëndrueshme ndaj lagështisë. Këto pllaka shpesh janë të përbërë nga një material i fortë dhe i qëndrueshëm, i mbuluar me një shtresë të thellë të lëmuar të plastikës, duke i bërë ato të përshtatshme për përdorim në mjedise të ndryshme dhe për aplikime të ndryshme ndërtimore.

4.3.1.6 Sharra Vertikale Format 4 Kappa V60

Makineria e parë në këtë linjë do të jetë Sharra Vertikale, do të përdoret për prerjen e paneleve HPL me precizion të lartë dhe për shkak të orientimit të saj vertikal, zë vetëm 5 metra katrorë.



Sharra Vertikale Format 4 Kappa V60 Tabela 5 Specifikat teknike Format Kappa V60

Thellësia e prerjes	60 mm
Gjatësia e prerjes lartësia e prerjes	3,300 mm / 4,300 mm 1,900 mm
	4,300 mm / 5,300 mm 2,200 mm
Lartësia e prerjes se pjesshme	1,810 mm / 2,110 mm
Diametri i sharrës (mm)	250 mm
Kërkesa për ajër	1400 m3/h
Norma e rrjedhës se ajrit	≥ 20 m/sec
Diametri i lidhjes së bashkëngjitjes	120 mm
pesha	900 kg - 1,200 kg
Fuqia e sharrës ne kw	4kw




Figura 22. Sharra Vertikale Format 4 Kappa V60 Tabela 5 Specifikat teknike Format Kappa V60

4.3.1.7 CNC Qendra e procesimit

I zhvilluar posaçërisht për përdorim të përgjithshëm, kjo makinë CNC e kthjellët është një zgjedhje e fitueshme dhe bind me precizion të lartë dhe produktivitet të imponueshëm në përpunimin e materialeve të ndryshme të paneleve.

Profit H08 nga Format4 është qendra e përpunimit CNC për aplikacione të profesionale të vendosjes në hapësira të vogla. Profit H08 21.31 ofron fleksibilitet dhe efikasitet maksimal dhe bën përshtypje tashmë me ekipimin bazik me 15 pozicione të mjetit. Për rezultate të përsosura pa shkurtesë, spindle kryesor është pajisur me një motor 12 kW.



FORMAT 4 Profit H08

Specifikat teknike te Profit H08

Lloji i Makinës	CNC Machining Center
Konsumi Elektrik	10 Kw
Lidhja Elektrike	5x6mm ²
Konsumi i Ekstraksionit të Ajrit	600m ³ /h
Lidhja e Ekstraksionit të Pluhurit	100mm
Konsumi i Ajrit të Kompresuar në nl/min	
Norma e Rrjedhjes së Ajrit	≥ 20 m/sec
Okupimi i Hapësirës në mm	8300x3400
Pesha në kg	1300kg

Figura 23. FORMAT 4 Profit H08

4.3.1.8 Sharra me Istruzion të Avancuar (Advanced Line 100)

Falë konstruksionit të fortë dhe karriges së fuqishme të daltës, forcat e prerjes transmetohen pa vibracione dhe me motorin fuqishëm të daltës, sharrat tona përpunojnë alumin, metale të pashtreta dhe plastikë me precizion të lartë dhe cilësi të prerjes. Me motorët e sharrës me fuqi 18.5 kW, këto makinat arrijnë norma të jashtëzakonshme të ushqimit dhe performancës së prerjes në çdo aplikim.



Mayer Advanced line 100 Tabela 7 Specifikat teknike të Mayer Advanced Line 100

Lloji i Makinës	Beam Saw
Konsumi Elektrik	24kwh
Lidhja Elektrike	5x6 mm ²
Konsumi i Ekstraksionit të Ajrit	4800m ³ /h
Lidhja e Ekstraksionit të Pluhurit	200mm
Konsumi i Ajrit të Kompresuar në nl/min	720nl/min
Norma e Rrjedhjes së Ajrit	≥ 20 m/sec
Okupimi i Hapësirës në mm	7600x6600
Pesha në kg	5500kg

Figura 24.Mayer Advanced line 100 Tabela 7 Specifikat teknike të Mayer Advanced Line 100

4.3.1.9 Veglat digjitale

Platforma e Procesimit Digjital të Menjëhershëm

Imos AG zhvillon dhe distribuon zgjidhje softuerike për kompanitë që projektuan dhe planifikojnë mobilje dhe elemente të mobilimit individualisht, i prodhojnë automatikisht dhe i shesin direkt.

iX Interio është teknologjia me të cilën Imos AG shoqëron kompanitë orientuar nga suksesi në industrinë e mobiljeve dhe dizajnit të brendshëm drejt të ardhmes dixhitale.



Figura 25.iX interio- skema se si funksionon

iX Interio digitalizon proceset - nga planifikimi dhe shitja, futja e porosisë dhe dizajni deri te organizimi i procesimit, procesimi dhe montazhi. Sistemi modular Imos iX përfshin të gjitha produktet e softuerit që mbështesin kompanitë konsistentisht nga shitja te dizajni dhe porosia, si dhe procesimi dhe montazhi deri te integrimi dhe bëjnë këto procese efikase. Produktet Imos iX janë parakonfiguruar, por mund të përshtaten individualisht me nevojat e një kompanie. Vetëm ose së bashku me sistemet e jashtme, ato krijojnë ekosistemin iX Interio.

4.3.1.10 Infrastruktura e Përgjithshme e Përdorshme

Kompresorë Ajri për Makinat

Kompresorët GA 30+-90 të Atlas Copco sjellin qëndrueshmëri të shkëlqyer, besueshmëri dhe performancë, duke minimizuar koston totale të pronësisë. Zgjedhja e llojit të kompresorit premium GA VSD ofron një zgjidhje ajri të kompresuar që përshtatet perfekt me kërkesat dhe ofron propozita vlerash të qarta.

Këta kompresorë janë ndërtuar për të performuar edhe në mjediset më të vështira dhe do të mbajnë procesimin të funksionojë me efikasitet.




Figura 26.Kompresori i ajrit

4.3.1.11 Sistemi i Ekstraksionit të Pluhurit

Është e qartë që pluhuri i drurit mbledhët në punishte dhe është gjithashtu i njohur gjerësisht se ky pluhur është klasifikuar si një rrezik për shëndetin për një kohë të gjatë, por është vetëm së fundmi që tema e ekstraksionit të pluhurit në këtë industrisë është bërë një temë reale për diskutim. Një rregullore e BE-së që pritet të hyjë në fuqi së shpejti do të lejojë kompanitë që kanë nevojë për filtrim të ajrit deri në 8,000 m³/h të përdorin ekstraktorë të pluhurit të ajrit të miratuar për pluhur druri, duke i shpëtuar investimit të shtrenjtë të një ekstraktori të vendosur jashtë. Megjithatë, përveç rregullave dhe rregulloreve të shumta, një gjë është gjithashtu e qartë: Punimi pa pluhur nuk është vetëm më i shëndetshëm, por ofron edhe shumë mundësi për kursim energjie dhe kostot në punishtat e përpunimit të drurit. Një zgjidhje e adaptuar individualisht për ekstraksion është thjesht e domosdoshme për një punishtë të shëndetshme. Ne kemi identifikuar ekstraktorë të pluhurit të ajrit të pastër dhe sisteme filtrimi për ekstraksion të efektshëm të shkëmbinjve dhe pastrim të ajrit. Felder RL 350 arrijnë një nivel përqendrimi të pluhurit të mbetur më pak se 0.1 mg/m³, në përputhje me nivelin e mbetur të përmbajtjes së pluhurit H3. Ndryshe nga ekstraktorët tradicionalë të pluhurit, Felder pozicionon ventilatorin pas filtrave. Kjo krijon një presion negativ në të gjithë sistemin, parandalon që pluhuri të shpëtojë përmes ndonjë këndeje.



Specifikat teknike te Felder RL 350

Lloji i Makinës	Dust Extractor
Konsumi Elektrik	11kw
Lidhja Elektrike	5x6mm ²
Konsumi i Ekstraksionit të Ajrit	-8000m ³ /h
Lidhja e Ekstraksionit të Pluhurit	350mm
Konsumi i Ajrit të Kompresuar në nl/min	n/a
Norma e Rrjedhjes së Ajrit	20m/s
Okupimi i Hapësirës në mm	2640x1140
Pesha në kg	n/a

Figura 27.Sistemi i ekstrhimit te pluhurit

Gjatë faza se dyte, kompania planifikon të bëjë investime të cilat përfshijnë:

- ❖ Përpunimi i Paneleve Druri (Prerje, Aplikim i Kanateve, Drutim) - industrisë së mobiljeve
- ❖ Linja e Procesimit të GRC

Lista e pajisjeve për - Përpunimi i Paneleve Druri (Prerje, Aplikim i Kanateve, Drutim) - industrisë së mobiljeve

4.3.1.12 Sharre me Istruzion Mayer Kappa 140

Me Sharrat e saj të rënda dhe të qëndrueshëm, Mayer fokusohet në cilësinë qëndrueshëm dhe ndërtim të makinerisë së klasit të parë. Konstruksioni i rëndë dhe i qëndrueshëm me kornizë çeliku dhe shtypësin material, operacioni i thjeshtë edhe kur punohet vetëm dhe besueshmëria maksimale e procesit me programin e optimizimit të prerjes të strukturuar modularisht, si dhe një paketë e re e softuerit, sigurojnë performancë dhe precizion maksimal në prerjen racional të paneleve.

Softueri i optimizimit të prerjes i strukturuar modularisht me etiketim barcode përfaqëson besueshmëri të lartë të procesit. Daltët me thikë kryesore dhe thikë për shkrim udhëtojnë përgjatë një sistemi të mbajtësit të shkronjave të kaluar dhe të gdhendura. Një sistem i precizuar shumë i drejtimit me ngrenë dhe me ngrenë rezulton në një lëvizje të shumë smooth të karriges së thikës me shpejtësi prerjeje nga 5 deri në 100 m/min.



Lloji i Makinës	Beam Saw
Konsumi Elektrik	24kwh
Lidhja Elektrike	5x6 mm2
Konsumi i Ekstraksionit të Ajrit	4800m3/h
Lidhja e Ekstraksionit të Pluhurit	200mm
Konsumi i Ajrit të Kompresuar në nl/min	720nl/min
Norma e Rrjedhjes së Ajrit	≥ 20 m/sec
Okupimi i Hapësirës në mm	7600x6600
Pesha në kg	5500kg

Figura 28.Pamje e sharres me instruzion Tabela 10 PSecifikat teknike te Mayer Kappa Automatic 140

4.3.1.13 Edge bander Tempora F800 60.12 e-motion

Koha, burimi më i rëndësishëm në një punishtë moderne, ishte një nga pikat kryesore gjatë zhvillimit të konceptit të ri të makinës tempora. Përpunimi i kanateve duhet të jetë sa më i shpejtë, i lehtë dhe efikas. Për të arritur këtë, modeli tempora kombinon karakteristikat kyçe të shpejtësisë, produktivitetit, fleksibilitetit dhe komoditetit të përdoruesit në një paketë të plotë bindëse. Rezultatet përfundimtare kur përpunohen materialet e kanateve të ngjitura dhe të shiritit binden me standarde shumë të larta, që përmbushin kërkesat e rritura të përpunimit të plotë të kanateve.



Specifikat teknike te Tempora 60.12

Lloji i Makinës	Edge Bander
Konsumi Elektrik	16kw/h
Lidhja Elektrike	5x6 mm ²
Konsumi i Ekstraksionit të Ajrit	1800m ³ /h
Lidhja e Ekstraksionit të Pluhurit	7x60mm, 200mm
Konsumi i Ajrit të Kompresuar në nl/min	500nl/min
Norma e Rrjedhjes së Ajrit	≥ 20 m/sec
Okupimi i Hapësirës në mm	6200x1200
Pesha në kg	2700kg

Figura 29.Tempora 60.12

4.3.1.14 Qendra e Përpunimit CNC Format 4 Creator 950

Creator 950, në një sërë opsionesh të pajisjeve, do të lejojë personalizimin e makinës për të përputhur me nevojat e Front LLC. Përpunimi i efikasëm CNC në një çmim të arsyeshëm, kjo është synimi i serisë së makinave Creator. Të gjitha modelat janë të pajisur me teknologjinë më moderne CNC dhe mund të përshtaten me nevojat specifike me pajisje individuale. Creator nuk është vetëm një hyrje e thjeshtë dhe e sigurt në botën e CNC, por gjithashtu mund të vepronte si një makinë shtesë për të lehtësuar ngarkesën e punës në qendrat e tjera të përpunimit CNC tuaja.



Specifikat teknike te Format4 Creator 950

Lloji i Makinës	CNC Machining Center
Konsumi Elektrik	14 kw/h
Lidhja Elektrike	5x4 mm ²
Konsumi i Ekstraksionit të Ajrit	3000m ³ /h
Lidhja e Ekstraksionit të Pluhurit	200mm
Konsumi i Ajrit të Kompresuar në nl/min	600nl/min
Norma e Rrjedhjes së Ajrit	≥ 28 m/sec
Okupimi i Hapësirës në mm	2400x2100
Pesha në kg	1950kg

Figura 30.Format4 Creator 950

4.3.1.15 Moldieri Format 4 Profil 45z

Elegant, perfektisht i projektuar dhe inteligjent – Format4 profil 45 Z ofron perfeksion në shtypjen e një butoni, pavarësisht nga operacioni. Pikat e forta për përdoruesin profesional: rregullimi i lartësisë dhe këndit të spindle-si, si dhe pozicionimi i mburojës së spindle-si mund të rregullohen shpejt dhe lehtë nga paneli i kontrollit. Sistemi i shpejtë i ndërrimit të spindlesë siguron kohë të shkurtër për ndërrim dhe efikasitet maksimal të procesimit.

Gjatë periudhave të larta të procesimit, veçanërisht në pikun e sezonit, Moldieri do të përdoret për të zvogëluar kohën e përpunimit të makinës CNC duke përfunduar kanate në makinë.



Specifikat teknike te Format Profit 45Z

Lloji i Makinës	Shaper
Konsumi Elektrik	8kw/h
Lidhja Elektrike	5x2.5 mm ²
Konsumi i Ekstraksionit të Ajrit	1110m ³ /h
Lidhja e Ekstraksionit të Pluhurit	140mm ,80mm
Konsumi i Ajrit të Kompresuar në nl/min	n/a
Norma e Rrjedhjes së Ajrit	≥ 20 m/sec
Okupimi i Hapësirës në mm	2870x1294
Pesha në kg	650kg

Figura 31.Format Profit 45Z

4.3.1.16 Kabina per larjen e ngjyres me uje

Kabina e larjes se ngjyres me uje ofron një mjet shumë efikas për heqjen e pjesëve të bojës nga ajri i nxjerrë duke përdorur ujin si një medium filtrimi.

Dhomat standarde te larjes me ujë përdoren për përdorim boje mesatar deri te shifra të larta, për pjesët mesatare ose të mëdha në madhësi dhe proceset grupore. Dhomat e përfshirjes së ngjyres me ekran uji përmbajnë veçori të veçanta si një tank uji ose tank për shfrytëzim të mbeturinave boje, eliminatorë të projektuar posaçërisht (baffles), pllaka tip çava, një dhomë larjeje dhe një fryrë me presion të lartë. Lloji i dhomës së përfshirjes së farës me bojë në bazë të ujit është më i popullarizuar kur konsumimi i bojës është 10-100 litra/turn, konsumim boje të rëndë, procesim i lartë dhe/ose për ndonjë komponent.

Kur boja shpërthehet në komponent, mbeturinat shtohen shpejt nga fryrësi qendror me presion të lartë përmes pllakës tip çava dhe eliminators. Duke krijuar një veprim tornadoje të lartë, grimcat e mbeturinave të bojës preken në pllakën tip çava, ndarë bojën e hollë drejt fryrësit dhe mbeturinat e

bojës në tank. Përzierja e hollë e bojës ose pluhuri i bojës eliminohet në dhomën e larjes. Boja aktualisht larët në këtë dhomë.

Avantazhi më i madh i Dhomës së Përfshirjes së ngjyres me ujë është se gërvirët e mbeturinave të bojës mbledhin në tankun e mbledhjes, duke ndihmuar përdoruesin të shpëtojë nga heqja e tyre lehtë.



Figura 32. Kabineti i larjes

Një tavolinë lëmimi është një komponent thelbësor i një punëtorie të shëndetshme. Nevoja për zgjidhje profesionale të nxjerrjes është njohur prej kohësh në industrinë e përpunimit të drurit, kështu që përdorimi i një tavoline lëmimi për punimet e lëimit manual është ankoruar edhe në ligj në Austri dhe Gjermani (GKV2011 §16a par. 3 dhe BGI 739). Pluhurat e grumbulluara kapen në mënyrë optimale dhe nxirren menjëherë. Tavolina lëmuese FST 160 si një ndërtim i qëndrueshëm dhe mund të rregullohet nga 28 $\frac{3}{8}$ "–40 $\frac{3}{8}$ " (726 mm në 1,026 mm) si standard. Duke zgjedhur montimin opsional të murit, është e mundur të kurseni hapësirë të vlefshme duke e ruajtur tavolinën e lëimit në një pozicion vertikal të fiksuar në përputhje me murin. Prandaj, tavolina e lëimit FST 160 është e përshtatshme për punëtori më të vogla.



Figura 33. Tavoline lërimi

4.3.1.17 Kompleti i veglave të lëimit

Mirka® DEROS 5650CV EU Ø 125/150 mm 5.0 mm orbita

Lëmues Mirka® DEROS është zhvilluar për lënim efektiv dhe pa pluhur të të gjitha llojeve të sipërfaqeve. Është skalori orbital i rastësishëm elektrik më i vogël dhe më ergonomik i drejtpërdrejtë në treg, i pajisur me një motor pa furça që ruan shpejtësi konstante edhe nën ngarkesë të madhe. Mirka® DEROS ka vlerat më të ulëta të dridhjeve në klasën e tij, duke shfaqur një sensor të integruar vibrimi dhe një dizajn unik simetrik që mundëson përdorimin e mjetit për periudha të gjata pa lodhje. Ky model ka një rënie 150 mm (6") dhe një 125 mm (5") dhe lëkundje 5.0 mm. Mirka® DEROS 5650CV shpërndahet në një kuti plastike me cilësi të lartë, së bashku me zgjidhjen e jastëkëve mbështetës 2-në-1.



Figura 34. Seti i veglave të lëimit

4.3.1.18 Piston pompa

Qëndrueshmëria dhe besueshmëria e lartë i bëjnë pompat e pistonit zgjedhjen ideale për aplikime me presion të ulët, të mesëm dhe të lartë dhe për aplikimin e bojërave me bazë uji dhe tretës. Motorët e ajrit me efikasitet të lartë sigurojnë funksionim të qetë. Motori dhe gjeometria e tij e veçantë e shkarkimit parandalojnë plotësisht ngrirjen dhe keqfunksionimet e shoqëruara. Kështu, rezultatet më të mira të veshjes janë të garantuara. Pompa e pistonit Wagner EvoMotion 5-60S është pompë ushqyese me presion të ulët për aplikime Airspray me material me viskozitet të lartë ose me tuba të gjatë. Deri në 35 bar dhe 3,6 l/min.



4.3.1.19 Pistoleta për spërkatje

Pistoleta e spërkatjes së bojës PHASER u zhvillua me pamjen e saj të veçantë vizuale, materialet speciale dhe një koncept të

[Mercom Company Sh.p.k.](#)

veçantë për projektet tuaja shumë të veçanta. Dizajni jashtëzakonisht elegant u zhvillua në bashkëpunim me Porsche Design Studio. Teknikisht, PHASER është identik me modelin më të lartë SATAjet X 5500. Ai ka të njëjtin koncept të grykës dhe të gjitha tiparet e tjera bindëse që e bëjnë SATAjet X 5500 një pistoletë të jashtëzakonshme për spërkatje të bojës.

Koncepti i këtij sistemi hundëzësh është i lehtë dhe i drejtpërdrejtë për t'u kuptuar: Të dyja teknologjitë e provuara të aplikimit - HVLP dhe RP - mbeten të disponueshme, por tani secila prej tyre ofron një zgjedhje shtesë midis grupeve të hundës I dhe O. Në përputhje me rritjen e madhësive të hundës brenda secilës prej teknologjive përkatëse (HVLP / RP), shpejtësia e rrjedhës së materialit rritet gjithashtu me rritje konstante. Që do të thotë se madhësia dhe gjerësia e ventilatorit të spërkatjes mbeten të pandryshuara në të gjithë spektrin e grykës. Në thelb, përdoruesit përfundimtarë tani mund të mbështeten në një sistem transparent dhe të qëndrueshëm, i cili u ofron atyre opsione të qarta dhe të strukturuar mirë aplikimi.



Figura 35. Pistoleta për spërkatje

5 IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

5.1.1 Ndotja e ajrit

Gjatë funksionimit të kompleksit të prodhimit të mobiljeve, pritet të ketë ndotje të ajrit kryesisht nga grimcat e pluhurit të krijuara gjatë procesit të prerjes, bluarjes, gdhendjes dhe lustrimit të drurit. Përpunimi i materialeve të ndryshme si druri, MDF dhe kompensata çon në formimin e grimcave mikroskopike që mund të përhapen në hapësirat e punës.

Gjithashtu, ndotja e ajrit mund të ndodhë nga përdorimi i pajisjeve ndihmëse si gjeneratorët në raste të ndërprerjeve të rrymës, si dhe nga qarkullimi i automjeteve që transportojnë lëndën e parë dhe produktet përfundimtare. Gazrat e lëshuara nga këto pajisje përmbajnë komponentë ndotës si CO, NOx, SO2 dhe pluhur të imët, të cilët ndikojnë në cilësinë e ajrit. Shkalla e ndotjes do të varet nga mikroklima e ambientit të brendshëm të fabrikës, si dhe nga kushtet klimatike dhe meteorologjike të zonës përreth.

5.1.2 Ndotja e ujit

Rreziku potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore vjen nga derdhjet aksidentale të mbetjeve të tretshme të ngjitësve, llakut dhe kimikateve të tjera të përdorura gjatë përpunimit dhe lyerjes së mobiljeve. Gjithashtu, mund të ketë rrjedhje të vajrave dhe derivateve nga pajisjet prodhuese dhe automatet që operojnë në hapësirat e fabrikës.

Ndotja mund të ndodhë edhe si rezultat i grimcave të pluhurit nga përpunimi i drurit, të cilat mund të shpërndahen përmes ujërave të shiut në sipërfaqet e platonit industrial. Vlerat më të larta të ndotjes priten gjatë stinës së dimrit, kur mund të ketë shpëlarje më të madhe të ndotësve për shkak të reshjeve të dendura dhe përdorimit të kripës në rrugët përreth fabrikës.

5.1.3 Ndotja e tokës

Ndotja e tokës në zonën e fabrikës mund të ndodhë si rezultat i sedimentimit të grimcave të drurit, bojërave dhe llakut të përdorur në procesin e përfundimit të mobiljeve. Për më tepër, mund të ketë ndotje aksidentale nga rrjedhjet e vajrave dhe kimikateve të përdorura në prodhim, të cilat mund të depërtojnë në dhe duke ndikuar në cilësinë e tokës.

Këto ndotje mund të shmangen përmes menaxhimit të duhur të mbetjeve dhe largimit të dheut të kontaminuar në hapësira të përshtatshme, duke siguruar që ndotja të mos përhapet në zonat përreth.

5.1.4 Zhurma

Prodhimi i mobiljeve përfshin përdorimin e makinerive prerëse, frezuesve, kompaktorëve dhe kompresorëve të ajrit, të cilët krijojnë një nivel të konsiderueshëm të zhurmës. Po ashtu, qarkullimi i vazhdueshëm i automjeteve për transportin e lëndës së parë dhe produkteve të gatshme mund të kontribuojë në ndotjen akustike të zonës.

Sipas vlerësimeve, niveli i zhurmës në ambientet e punës do të jetë brenda kufijve të lejuar, duke mos tejkaluar 60 dB, falë izolimit të mirë akustik dhe distancës së fabrikës nga zonat e banuara.

5.1.5 Ndikimi në florë dhe faunë

Ndikimi i drejtpërdrejtë në florë dhe faunë nga ky aktivitet industrial pritet të jetë minimal. Zona e fabrikës ndodhet në një hapësirë industriale, ku nuk ka zona të mbrojtura ose habitate natyrore të ndjeshme. Ndikimi mund të vijë kryesisht nga pluhuri dhe emetimet e ajrit, por për shkak të masave mbrojtëse, nuk pritet të ketë dëme të konsiderueshme në ekosistemet lokale.

5.1.6 Ndikimet në raste aksidentale

Ndikimet aksidentale mund të përfshijnë rrjedhjet e lëndëve të rrezikshme si llaku dhe ngjitësit industrialë, të cilët mund të ndotin ajrin, tokën dhe ujërat nëse nuk menaxhohen siç duhet. Po ashtu, rreziku i zjarrit është një faktor i rëndësishëm, duke qenë se përpunimi i drurit përfshin lëndë djegëse dhe pajisje elektrike që mund të shkaktojnë ndezje.

Për të minimizuar këto rreziqe, do të ndërmerren masa mbrojtëse si vendosja e sistemeve kundër zjarrit, ruajtja dhe menaxhimi i sigurt i kimikateve, si dhe trajtimi i mbetjeve sipas standardeve mjedisore.

Përfundim: Në bazë të analizës së ndikimit mjedisor, kompleksi i prodhimit të mobiljeve pritet të ketë një ndikim minimal në mjedis, për sa kohë që zbatohen masat e duhura për menaxhimin e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës. Implementimi i teknologjive të avancuara për kontrollin e mbetjeve dhe emetimeve do të ndihmojë në minimizimin e efekteve negative dhe do të sigurojë një funksionim të qëndrueshëm të fabrikës.

6 MASAT PËR ZVOGËLIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS

Gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit kompania duhet të i ndërmarrë të gjitha masat për mos ndikimin në ujë, toke, ajër, masat ndajë komunitetit etj.

6.1.1 Masat për eliminimin e ndikimeve të dëmshme

Sipas analizës së bërë mbi ndikimin e fabrikës për prodhimin e mobiljeve në mjedis dhe në bazë të vlerësimit të lokacionit ku është ndërtuar fabrika, si dhe rekomandimeve të dhëna në këtë raport, fabrika me veprimtarinë e saj të vazhdueshme nuk rrezikon mjedisin, pasi janë realizuar shumë nga parakushtet e nevojshme për mbrojtjen adekuate të tij. Megjithatë, në rast se ndodh ndotja, duhet të ndërmerren masa për parandalimin ose së paku zvogëlimin e ndikimeve negative, duke i mbajtur ato brenda kufijve të lejuar sipas legjislacionit në fuqi.

Me qëllim të zvogëlimin të ndikimeve potenciale negative në mjedis, rekomandohet ndërmarrja e masave që përfshijnë menaxhimin e rrezikut në rrethanat e jashtëzakonshme dhe të rregullta, në përputhje me standardet ISO 45001:2018 për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë dhe ISO 14001:2015 për Menaxhimin Mjedisor.

6.1.2 Masat për mbrojtjen e ajrit

Qëllimi i këtij raporti është identifikimi i ndotjeve të mundshme dhe ndërmarrja e masave për mbrojtjen e mjedisit përreth fabrikës së prodhimit të mobiljeve. Për të parandaluar dhe zvogëluar ndotjen e ajrit gjatë fazës së zhvillimit të aktiviteteve prodhuese, kompania do të pajiset me një sistem filtrimi të pluhurit dhe grimcave të drurit, të cilat krijohen gjatë prerjes dhe përpunimit të materialeve. Këto grimca do të filtrohen dhe deponohen për përdorim të mëtejshëm si lëndë e parë për briket.

Mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve prodhuese, filtrave dhe sistemit të ventilimit do të jetë një prioritet për të siguruar një ambient të pastër pune. Ventilatorët me filtra do të instalohen për pastrimin e ajrit brenda hapësirës prodhuese, duke u kombinuar me hapjet për hyrjen e ajrit të pastër. Po ashtu, do të bëhet matja e cilësisë së ajrit në përputhje me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes. Të dhënat e fituara nga matjet do të dorëzohen tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) sipas afateve të përcaktuara me aktet ligjore.

6.1.3 Masat mbrojtëse të ujërave

Edhe pse në kompleksin e fabrikës nuk do të zhvillohen procese që të shkaktojnë ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ekziston mundësia e ndotjes nga rrjedhjet aksidentale të vajrave, llakut dhe substancave të tjera të përdorura në prodhim. Për këtë arsye, fabrika do të pajiset me një sistem të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

Kompania duhet që të matjen e cilësisë së ujërave të shkarkuara, dhe se vlerat e fituara duhet të krahasohen me vlerat e caktuara me udhëzimin administrativ 13 / 2008. Vlerat e cilësisë së ujit të shkarkuar nuk guxojnë të jenë më të larta se ato të përkufizuara në udhëzim administrativ.





Figura 36. Skema e trajtimit të ujërave fekale.

Do të instalohet një separator për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga ujërat e ndotura, i cili do të pastrohet rregullisht nga ndërmarrje të licencuara. Gjithashtu, do të ndërtohet një gropë septike për trajtimin e ujërave të zeza, pas së cilës ujërat e trajtuara do të dërgohen në një bunar filtrues. Ujërat e trajtuara nuk do të lëshohen në natyrë pa u filtruar nëse përmbajnë derivate mbi 1 mg/l dhe materie të suspenduara mbi 30 mg/l, duke respektuar standardet mjedisore në fuqi.



Skema e trajtimit te ujerave

6.1.4 Masat për mbrojtjen e tokës

Për të parandaluar ndikimet negative në tokë gjatë fazës së prodhimit të mobiljeve, duhet të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Hapësirat operationale të mbulohen me beton ose asfalt për të shmangur kontaminimin e drejtpërdrejtë të tokës.
- Furnizimi me ujë për larjen e platonit, ujitjen e sipërfaqeve gjelbëruese dhe përdorimin për zjarrfikje të bëhet nga rrjeti lokal.
- Ujërat e ndotura nga sipërfaqet manipulative duhet të grumbullohen dhe të kalojnë përmes një separatori për ndarjen e derivateve dhe vajrave.
- Ujërat fekale nga nyjat sanitare duhet të dërgohen në një gropë septike të posaçme.
- Seperatori duhet të kontrollohet rregullisht dhe të pastrohet sipas kërkesave ligjore për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme.
- Kontejnerët për mbeturinat komunale duhet të jenë të pajisur me kapak dhe të zbrazën rregullisht në deponinë rajonale.
- Mbetjet e lëngëta duhet të deponohen në enë të posaçme për trajtim të mëtejshëm.
- Sipërfaqet e pa betonuar dhe asfaltuar duhet të mbillen me bar dhe drunj dekorativ për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe aspektit vizual.

6.1.5 Masat për mbrojtjen nga zjarri

Për të parandaluar dhe reaguar ndaj zjarrit, do të merren masat e mëposhtme:

- Instalimi i hidrantëve dhe aparateve mobile zjarrfikëse në pika strategjike.
- Vendosja e aparateve zjarrfikëse të tipit S9 dhe të tjera sipas nevojës.
- Në rast rrjedhjeje të vajrave dhe lubrifikantëve, sipërfaqja duhet të pastrohet me absorbues kimik ose me ashkla druri, të cilat deponohen në fuçi të posaçme për trajtim të mëtejshëm.
- Kontrolli periodik i instalimeve elektrike dhe sistemit të sigurisë nga zjarri.
- Monitorimi i ambientit të kompleksit të fabrikës për të parandaluar rreziqet e mundshme.

- Evakuimi i punëtorëve në raste emergjente dhe sigurimi i një plani të detajuar të sigurisë kundër zjarrit.
- Implementimi i masave për të parandaluar zjarrvënien e qëllimshme.

6.1.6 Masat për mbrojtjen nga zhurma

- Matjet e nivelit të zhurmës do të kryhen në përputhje me rregullat dhe standardet në fuqi, sidomos në afërsi të zonave të banuara.
- Vlerat e lejuara të zhurmës:
 - Zhurma ditore (7:00-19:00) – 55 dB
 - Zhurma e mbrëmjes (19:00-23:00) – 55 dB
 - Zhurma e natës (23:00-7:00) – 45 dB
- Në rast se vlerat e matura e tejkalojnë normën e lejuar, do të merren masa për uljen e nivelit të zhurmës, si përdorimi i barrierave akustike dhe zhvendosja e pajisjeve të zhurmshme në vende të përshtatshme.
- Punonjësit në zona të ndjeshme duhet të pajisen me mjete mbrojtëse kundër zhurmës (kufje ose tapa për veshët).

6.1.7 Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore – zjarri

Në rast të një aksidenti mjedisor ose zjarri:

- Do të bëhet evakuimi i detyrueshëm i personave në rrezik.
- Do të sigurohet lokalizimi dhe shuarja e zjarrit për të ruajtur integritetin e objektit dhe personelit.
- Materialet ndërtimore jo të djegshme do të përdoren për reduktimin e rrezikut të përhapjes së zjarrit.
- Do të zvogëlohet sasia e ngarkesës së zjarrit në ambientet prodhuese përmes përdorimit të materialeve më pak të ndezshme.
- Do të instalohen pajisje kundër zjarrit të lehta për përdorim nga punëtorët.
- Do të hartohet dhe zbatohet plani emergjent i ndërhyrjes sipas standardeve dhe rregulloreve në fuqi.

6.1.8 Masat për mbrojtjen e florës dhe faunës

- Për shkak të natyrës industriale të zonës, ndikimi në florë dhe faunë pritet të jetë minimal.
- Nuk do të ketë zhdukje të vegjetacionit përveç sipërfaqeve të destinuara për ndërtim.
- Për të minimizuar ndikimet negative në ajër dhe tokë, do të ndërmerren masa të rrepta për menaxhimin e mbetjeve dhe shmangien e ndotjeve të paplanifikuara.
- Kompania duhet të shmangë deponimin e mbetjeve në vende të papërshtatshme dhe të sigurojë që mbeturinat të trajtohen sipas rregullave ligjore.
- Për të reduktuar ndikimin vizual dhe ndotjen e ajrit, do të realizohet gjelbërimi i hapësirave përreth fabrikës.

6.1.9 Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidentale

- Kompania do të përgatisë një plan emergjent për menaxhimin e aksidenteve ekologjike dhe mbrojtjen nga zjarri.
- Perimetri i fabrikës do të rrethohet për të siguruar sigurinë dhe parandalimin e qasjes së paautorizuar.
- Do të merren masa për parandalimin e derdhjeve aksidentale të derivateve dhe vajrave nga makinat dhe pajisjet e ngarkimit.
- Do të sigurohet një menaxhim i rreptë i trafikut të automjeteve transportuese brenda kompleksit për të shmangur pengesat dhe rreziqet.
- Masa shtesë do të implementohen në përputhje me Ligjin për Sigurinë në Punë.
- Për të parandaluar pasojat e mundshme, kompania duhet të zhvilloj plan të menaxhimit të rrezikut nga aksidentet mjedisore. Gjithashtu duhet të përgatit një plan për parandalimin e zjarrit, por edhe plan për menaxhimin e situatave në raste të zjarrit.
- Si masë parandaluese, i tërë lokacioni duhet të jetë i rrethuar, mbrojtur nga ndikimet fizike të jashtme. Duhet të vendosen rrethoja adekuate. Duhet të merren masat e sigurisë për evitimin e derdhjes së vajrave apo derivateve.
- Duhet që të ndërmerren të gjitha masat e sigurisë, konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe të mjedisit të punës.
- Objekti duhet të pajiset me masa të nevojshme për fikjen ezjarreve, qoftë me ujë ose me bombola adekuate për fikjen dhe parandalimin e përhapjes së zjarrit. Vendndodhja e aparaturave për fikjen e zjarreve duhet të jetë sipas standardeve për siguri nga zjarret. Me detajisht, shih raportin kundër zjarrit.

6.2 Menagjimi i mbeturinave

Duhet të vendosen kontejner të veçantë për nevoja të veprimtarive afariste në kuadër të objektit. Veprimtaria përpunuese duhet që bartjen dhe asgjësimin e mbeturinave ta vendos nën autoritetin e kompanisë përgjegjëse regjionale që vepron në qytetin-komunën e Lipjanit. Gjithashtu duhet të plotësohen të gjitha udhëzimet dhe rregullat e autoritetit përgjegjës lidhur me mënyrën e grumbullimit dhe deponim-it të mbeturinave.

Kontejnerët duhet të jenë të veçantë edhe për nga klasifikimi i mbeturinave në mënyre që deponimi i tyre mund të bëhet i klasifikuar. Rekomandohet që kontejnerët duhet të jenë nga materiali plastikë-gomë me qëllim të evitimit të çfarëdo mënyre jo adekuate të asgjësimit të mbeturinave.

Gjithashtu, kontejnerët duhet të vendosen në bashkëpunim me kompaninë përkatëse që benë grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave në qytetin apo komunën e Lipjanit kështu që është paraparë hapësira me nga 4 kontejner prej 240 litrave për koleksionim të mbeturinave plastikë, letër. Hapësirat për mbeturina do të ndërtohet nga Investitori brenda kompleksit ashtu siç janë në situacion të cilat do të jene te tipit e mbuluar në mënyrë që kontejnerët mos ti ekspozohen kushteve klimatike dhe të reshurave atmosferike.

Hapësira ku do të vendosen kontejnerët special për mbeturina do të drenazhohet të sigurohet me sistem për mbrojtje kundër zjarrit, dhe të ketë ajrosje të mirë. Kontejnerët do të evidentohen me shenja

adekuate se për cilën lloj të mbeturinave janë të dedikuara dhe të pajisen me pjesë ndihmëse. Vendosja e kontejnerëve është paraqitur në skicën e bashkangjitur.



Figura 37. Kantata për klasifikimin e mbeturinave ditore.

6.2.1 PROGRAMI I MONITORIMIT

Fabrika e mobiljeve nuk parashikon përdorimin e lëndëve djegëse, procese djegieje apo furra me temperatura të larta, si dhe nuk parashikon shkarkime të ujërave të zeza nga proceset teknologjike. Prandaj, nuk është e detyrueshme monitorimi i përhershëm i treguesve mjedisorë. Megjithatë, rekomandohet që investitori të monitorojë periodikisht treguesit kryesorë të trysnisë në mjedis si: ujerat fekale, ajrin dhe zhurmën.

6.2.2 RAPORTIMI

Raportimi do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxhmenti ose nga ekspertët e kompanisë. Raporti duhet të përfshijë të dhënat për monitorimin, sipas kërkesave të përcaktuara në pëlqimin mjedisor apo lejen mjedisore.

6.2.3 MASAT REHABILITUESE PAS PËRFUNDIMIT TË AKTIVITETIT

Pas përfundimit të aktivitetit prodhues, të gjitha pajisjet e impiantit duhet të çmontohen dhe të largohen nga zona. Bazamentet dhe platotë e betonit duhet të shkatërrohen, të imtësohen dhe të transportohen në deponinë regjionale. Materialet e mbetura nga procesi i prodhimit, si druri, metali, dhe betoni duhet të largohen dhe zona përfundimtare duhet të mbulohet me dhe, me një trashësi prej 0.5 m, duke u përshtatur me substratin e tokës ekzistuese.

Rikultivimi i sipërfaqeve të dëmtuara ose degraduara për shkak të veprimtarisë do të përfshijë rivitalizimin e plotë të hapësirës, në përputhje me qëllimin e përdorimit të tokës, siç është parashikuar nga planet komunale. Gjatë procesit të marrjes së lejes ndërtimore, kompania është e detyruar të përgatisë një projekt rikultivimi, i cili është i domosdoshëm për marrjen e lejes ndërtimore.

6.2.4 KONKLUZION

Në rastin e fabrikës së mobiljeve, kushtet e lokacionit nuk parashikojnë ndikime të mëdha mjedisore përveç atyre që lidhen drejtpërdrejt me veprimtarinë. Toka është e destinuar për ndërtim sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Ndikimet e mundshme mjedisore përfshijnë:

- Rrezikun nga zjarri i mundshëm;
- Mbeturinat e materialeve (gjatë fazës së ndërtimit dhe prodhimit).

Mbetjet dhe mbeturinat e përdorura në veprimtari duhet të grumbullohen në kontejnerë dhe të largohen në mënyrë të organizuar. Asnjëherë nuk duhet të digjen apo të lihen në mjedis të hapur, pasi kjo mund të përbëjë rrezik për mjedisin përreth dhe është e dënueshme sipas legjislacionit në fuqi.

Në këtë veprimtari, zjarret janë potencialisht të mundshme dhe mund të shkaktohen aksidentalisht. Për këtë arsye, do të përgatitet një raport i veçantë për mbrojtjen kundër zjarrit.

Gjatë punimeve të ndërtimit, pritet të krijohen mbetje të materialeve ndërtimore. Kompania duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mos ndotur mjedisin dhe për të parandaluar dëmtimin e pronave fqinje.

7 REFERENCAT

- Plani-Zhvillimor-Komunal
- Çavolli. R. 1997, Gjeografia regjionale e Kosovës
- Regjistrimi i Popullsisë, Agjencia e Kosovës për Statistika
- Ligji i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
- Raport për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, 2008-2010, AMMK 2011
- Raport për Gjendjen e Natyrës në Kosovë, 2009, AMMK 2010
- <https://www.ammkrks.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20per%20gjendjen%20e%20natyres%202018-%202021%20 SHQIP.pdf>